

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7367 E martë 28 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga MIRON ÇAKO

Festat e 28-29 Nëntorit na sjellin në kujtesë retrospektive ngjarjet historike të themelimit të kombit dhe shtetit shqiptar në vitin 1912 dhe çlirim prej ...
Vijon në faqen 21-22

Kombet, parë në një këndvështrim dhe perspektivë tjetër



Opinion

Ditës

Nga NEBIL ÇIKA

Së pari, dua të sqaroj një keqkuptim me një shkrim të botuar dje në "GSH" për një projektligj për dekomunistizimin që PD-ja në bashkëpunim po përgatit...
Vijon në faqen 21

Dekomunistizimi, punë e pambaruar e PD-së



Si u përfshinë në aksident 4 makinat, situata

Mbledhja e 2 qeverive në Korçë, përplasjet eskorta e Ramës, një gardist më rëndë

"Erion Musai ka dalë nga gjendja reanimatore. Ka dëmtime të mëdha në shtyllën kurrizore"

Dy makina të eskortës së kryeministrit Edi Rama janë aksidentuar në hyrje të qytetit të Korçës, ndërsa kanë mbetur të plagosur tre gardistë. Mësohet se ngjarja ka ndodhur pasditen e djeshme, rreth orës 14:00, në aksin rrugor Maliq-Korçë pranë fshatit Bulgarec, teksa mjetet po shoqëronin kreun e qeverisë për ...

Në faqen 8

POLICIA: INES HAJRULLA, ME PRECEDENTE TE THEKSUAR KRIMINALE, JA PISTAT

EKSPLOZIV MAKINES NE VLORE, GJYMTOHET DJALI I BIZNESMENIT

Dëshmitarët: Makina ishte duke ecur kur shpërtheu. 25-vjeçari na kërkonte ndihmë: 'O vëlla, ju lutem më ndihmoni!' Këmbët i ishin copëtuar



(Në foto) Policia në vendin ku shpërtheu makina. I plagosuri Ines Hajrulla

Në faqen 9

MESAZHI PER METEN

Donald Trump: Reforma në drejtësi, kyç për afrimin me BE

Në faqen 5

KONFERENCA

Alibali te "Luarasi":

Leksion i hapur për marrëveshjen e detit me Greqinë

Në faqen 11

PAVARESIA

Ndryshon qëndrimi

i historianëve,

Meta: Esat Toptani mbrojtë Shkodrën

Në faqen 10

LISTA EMERORE

Provimi i shtetit, mjekët, infermierët e stomatologët që hyjnë në garë

Në faqen 13-17

KALON PROJEKTBUXHETI



Shtesë page e punonjës, ja cilët përfitojnë nga Kuvendi, te SHISH dhe te Drejtësia

Në faqen 6

Qeveritë e Shqipërisë e Kosovës nënshkruajnë 12 marrëveshje e memorandume

Edi Rama: Mbledhja s'është provokim

Haradinaj: Do unifikojmë doganat. Dy kryeministrit mbështesin Metën

Nga DARINA TANUSHI

Një mbledhje me simbolikë bashkimin rreth një flamuri mund të quhet takimi i djeshëm mes dy kabineteve qeveritare të Kosovës dhe Shqipërisë. Kjo mbledhje e lajmëruar prej kohësh pati



dje seancën plenare, ku u nënshkruan gjithsej 12 marrëveshje e memorandume bashkëpunimi, pikërisht në Shtëpinë e Flamurit, një prej ndërtesave simbol të qytetit të Korçës. Dy qeveritë e organizuan këtë takim të katërt nën moton "Një popull, ...

Në faqen 2-3

KOSOVE-SHQIPERI MBLEDHJA

Rama pret Haradinajn nën borë. Kryeministri kosovar: Ndhimë për njohjet

Mbledhja Shqipëri-Kosovë, 12 marrëveshjet që u firmosën

Dy kabinetet festojnë sot në Vlorë Ditën e Pavarësisë

Darina Tanushi

Një mbledhje me sim bolikë bashkëpunim rreth një flamuri mund të quhet takimi i djeshëm mes dy kabinetëve qeveritarë të Kosovës dhe Shqipërisë. Kjo mbledhje e lajmëruar prej kohësh pati dhe seancën plenare, ku u nënshkruan gjithësej 12 marrëveshje e memorandume bashkëpunimi, pikërisht në Shtëpinë e Flamurit, një prej ndërtesave simbol të qytetit të Korçës. Dy qeveritë e organizuan këtë takim të katërt nën moton "Një popull, një endërr". Ndërkohë që sot ata do të marrin pjesë në festimet për Ditën e Pavarësisë në qytetin e Vlorës. Moti nuk ka qenë aq mikpritës në Korçë, pasi sapo kishin nisur flokët e parë të borës në qytet, por protokollin zyrtar me respektimin e dy himneve u zbatua korrektësisht. Kryeministri Edi Rama madje ka hequr pallton dhe ka larguar çadrën kuq e zi që mbante vetë në dorë dhe i ka bërë të gjitha respektet "mysafirrit" prej Kosovës, siç e cilësoi ai. Në fjalën e mirëseardhjes, kryeministri shqiptar, Edi Rama tha: "Ne mund të themi me plot gojë se ka ende shumë për të bërë, por me patjetër, çka është bërë në këtë përpjekje të përbashkët, nuk është pak". Duke folur për deklaratën e përbashkët për "bashkëpunimin dhe Partneritetin Strategjik" mes dy vendeve, të nënshkruar në Prizren më 11 janar të 2014-ës, Rama tha se, "edhe pse ka përfunduar linja e interkonjeksionit 400 KW mes dy vendeve, që për fat të keq ende nuk po vihet në punë për shkak të mungesës procedurale të krijuara nga jashtë, mbetemi në një impase sa të palogjikshëm, aq edhe të dëmshëm, në raport me këtë investim kaq të rëndësishëm. Kjo linjë e interkonjeksionit 400 KW është pa as më të voglin dyshim, një aks strategjik për të rritur ndërveprimin dhe jo thjesht për të afruar shumë më tepër të dy shtetet tona, por për të konsoliduar një proces tërësor rajonal. Të parët e kësaj linje si thjesht një linjë mes Shqipërisë dhe Kosovës është një mënyrë të pari me të cilën ne nuk pajtohem dhe për të cilën do të vazhdojmë të

bëjmë përpjekje që të ndryshojë", u shpreh Rama. Ai tha gjithashtu: "Jemi angazhuar po ashtu për të de-gëzuar gazsjellësin Trans-Adriatik për në Kosovë e më tej në rajon, çka do të krijojte akses në këtë linjë të rëndësishme të furnizimit me gaz edhe shtetit të Kosovës". Rama theksoi se do të fuqizojnë veprimin diplomatik në mbështetje të aspirat-

ave euro-atlantike të Kosovës. Kryeministri shprehen që me nënshkrimin e marrëveshjeve të reja, do t'i jepet shtytëse nxitje të investimeve të ndërsjella. "Askush nuk mund të na pengojë më që të bëhemi edhe ne shkronjës të historisë së Europës moderne", tha dje Rama. Nga ana e tij, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj u shpreh, "se ky vit i cilësuar edhe

si Viti i Skënderbeut pasqyron në vete ëndrën tonë euro-atlantike, të cilën më së miri e realizojmë së bashku". Duke renditur ndryshimet e bëra në Kosovë, Haradinaj tha: "Jemi të vendosur për dialogun me Serbinë, por dialogun e mendojmë tani në momentet finale dhe mendojmë se epilogu i dialogut duhet të sjellë njohjen mes Kosovës dhe Serbisë dhe që dialogu të arrijë epilogun e duhur, e mendojmë të nevojshme pjesë-marrjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Europian dhe SHBA". "Porcimi i Kosovës dhe forcimi ynë në Ballkan përshpejtohet më mirë me bashkëpunimin mes Kosovës dhe Shqipërisë. Prandaj, puna e mirë që keni bërë i nderuar kryeministër për arritjet e këtij takimi të përbashkët dhe mundësia që të nënshkruajmë 12 marrëveshje e protokolle dhe njëkohësisht, puna e bërë, e avancuar, që do të çojë në të ardhmen e afërt deri në unifikimin e doganave, mendoj se na bën të ndihemi krenarë, por nuk mjafton".



Ministrit dje duke firmosur marrëveshjet

MEMORANDUMET DHE MARRËVESHJET QË U NËNSHKRUAN DJE:

- Memorandumin e mirëkuptimit për bashkëpunimin në fushën e politikës së jashtme. Ky memorandum u nënshkrua nga ministri Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli dhe homologu i tij nga Shqipëria, Ditmir Bushati.
- Memorandum bashkëpunimi midis zyrës së kryeministrit të Shqipërisë dhe zyrës së kryeministrit të Kosovës për shkëmbimin e përvojave dhe bashkëpunimin për zbatimin e rregullimit më të mirë, vlerësimin e ndikimit dhe përmirësimin e praktikave të zhvillimit të politikave.
- Ky memorandum u nënshkrua nga zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj dhe ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj.
- Memorandum për bashkëpunimin në fushën e politikës së jashtme dhe marrëveshjen e bashkëpunimit në kuadër të bashkëpunimit në anëtarësimin evropian.
- Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e diasporës.
- Marrëveshja u nënshkrua nga ministri Dardan Gashi dhe ministri Pandeli Majko.
- Marrëveshje bashkëpunimi për qendrat kulturore në diasporë.
- Edhe ky marrëveshje u nënshkrua nga ministrit Gashi e Majko.
- Marrëveshje për vërtetimin e periudhave të sigurimit për realizimin e të drejtës në pension. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga ministri Skënder Reçica dhe ministri Arben Ahmetaj.
- Memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e ndërmarrjeve në Kosovë-KIESA dhe Agjencisë Shqiptare të zhvillimit të Investimeve AIDA. Ky memorandum u nënshkrua nga ministri Bajram Hasani dhe ministri Arben Ahmetaj.
- Marrëveshje për financimin dhe organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë.
- Marrëveshja u nënshkrua nga ministria Lindita Nikolla dhe ministri Dardan Gashi.
- Memorandum bashkëpunimi mes MKRS-së dhe Ministrisë së Kulturës të Shqipërisë.
- Protokoll për bashkëpunimin teknik dhe ekonomik në fushën e bujqësisë për njohjen bilaterale të certifikatave veterinarë dhe produkteve me origjinë shtazore dhe jostazore.
- Kjo marrëveshje u nënshkrua nga zv.ministri i Bujqësisë, Vesel Krasniqi dhe ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Niko Pelesh.
- Memorandum mirëkuptimi për themelimin e bursës së përbashkët të energjisë elektrike të Kosovës dhe Shqipërisë. Memorandumi u nënshkrua nga ministri Valdrin Lika dhe zv.ministri i Infrastrukturasë dhe Energjisë, Artan Shkreli.



Kryeministri Edi Rama dhe homologu kosovar, Ramush Haradinaj, dje në mbledhjen e përbashkët në Korçë

DIASPORA

Duke folur për diasporën, kryeministri u shpreh: "Një dinamike e re në marrëdhëniet mes dy vendeve ndikon drejtpërsëdrejti në prosperitetin e hapësirës mbarëshqiptare. Përveçse do të fuqizojmë bashkëpunimin përhapjen e kulturës dhe gjuhës shqipe për diasporën, do të punojmë për të riparë strukturat dhe për të krijuar mekanizmat, që do të veprojnë bashkë me Kosovën për ta bërë diasporën tonë pjesë dhe kontribuuese të rrugëtimit të përbashkët", tha Rama.



Tritan Shehu viziton shqiptarët e prekur nga tërmeti në Greqi: Qeveria t'i ndihmojë

Deputeti i Partisë Demokratike, Tritan Shehu vizi toji nga afër dhjetëra familje shqiptare të dëmtuara rëndë nga përmbytjet në Greqi. Shehu shprehu ngushëllimet për viktimat dhe solidaritetin me familjet e prekura nga përmbytja. "Fillova këtë vizitë pune në Athinë me takimin me bashkatdhetarët e përmbytur e të dëmtuar rëndë në Mandra. Ishte një fatkeqësi shumë e rëndë natyrore, që bëri të humbin shumë jetë njerëzish, si dhe solli dëme të pallogaritshme materiale për të gjithë, grekë e shqiptarë. Ngushëllimet më të thella për viktimat! Të gjithë solidaritetin të dëmtuar nga kryetari Basha, nga PD dhe nga unë personalisht", tha dje Shehu në një postim në "FB". Ai apeloj për ndihmë nga qeveria e shtetit shqiptar për familjet shqiptare që ndodhen në vështirësi, për tejkalimin e kësaj situatë të vështirë. "Është e domosdoshme edhe një mbështetje aktive e konkrete nga shteti shqiptar si dhe institucione të ndryshme tonat. Kryqi i Kuq i Shqipërisë mund të luajë një rol të rëndësishëm në tejkalimin e këtyre pasojave shkatërrimi e vuajtjeje për ata qytetarë. Shpresoj që normaliteti të kthehet sa më shpejt në Mandra", tha Shehu.



Dy kryeministrat e Kosovës e Shqipërisë: Ëndrra jonë, integrimi në BE

Rama: Mbledhja s'është provokim Haradinaj: Unifikojmë doganat

Nënshtetësia e kosovarëve, Rama mbështet qëndrimin e Metës

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje pas mbledhjes me qeverinë kosovare se të tilla takime nuk janë provokim për të tjerët, por janë takime për të bërë më shumë. Në konferencën e përbashkët për mediat, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, nga ana e tij vlerësoi mbledhjen, ndërsa tha se Kosova ka perspektivë. Ajo që u vu re në konferencën e tyre për shtyp ishte fakti se në disa raste kryeministri i Kosovës, Haradinaj nuk pati asgjë për të shtuar në përgjigjet që u dha pyetjeve të gazetarëve kryeministri Edi Rama, edhe pse ata u janë drejtuar të dyve. I pyetur në lidhje me komentin e Presidentit të Republikës serbe të Bosnjës, Milorad Dodik se pjesën e Kosovës mbi lumin Iber, në të ardhmen e sheh si pjesë të Serbisë, kryeministri Rama tha: "Ballkani është i lirë dhe secili ka të drejtë të shikojë ëndrrat e veta, po ne nuk jemi këtu për të komentuar ëndrrat e të tjerëve. Në ëndrrën tonë e kemi të qartë edhe askush nuk na ndalon në realizimin e saj". Deklaratën e Ramës e përkrahu totalisht edhe Haradinaj. "Jam i gëzuar që ne sot përmbyllim 12 marrëveshje të ndërsjella Shqipëri-Kosovë. Njëkohësisht jemi po ashtu në punë për të mbyllur edhe një protokoll të kalimit të kufirit, i cili është një protokoll që lehtëson krijësisht kalimin e kufirit Kosovë-Shqipëri dhe po punojmë intensivisht në unifikimin doganor. Pala e Kosovës ka ngecur, mirëpo jemi në proces dhe do të arrijmë aty", tha Haradinaj. Kryeministri i Shqipërisë, Rama u shpreh se mbledhja mes dy qeverive "flet vetë për një bilanc arritjesh dhe angazhimesh të rëndësishme, bazuar mbi sa kemi bërë deri më sot". Duke mos u ndaluar në marrëveshjet që miratuan, Rama tha: "Ne jemi shumë të vendosur për ta fuqizuar më tej veprimin e përbashkët politik dhe diplomatik në një angazhim tërësor, qoftë në marrëdhëniet tona bilaterale si dy shtete shqiptare, qoftë në qasjen tonë rajonale dhe qoftë në rrugën tonë të përbashkët drejt integritimit të plotë në familjen europiane". I pyetur në lidhje me dhënien e nënshtetësisë sh-



Kryeministri Edi Rama dhe homologu kosovar, Ramush Haradinaj

MBLEDHJA Kryeministri Edi Rama bëri të ditur dje se, "mbledhja e radhës midis dy qeverive me propozim të zëvendëskryeministrit të parë të Kosovës do të mbahet në Pejë". Ky ishte takimi i katërt midis kabineteve të Kosovës e Shqipërisë, pas të parit që startoi në Prizren.

Mungesat

MBLEDHJA
Në mbledhjen e djeshme të dy qeverive munguan zv.kryeministria Senida Mesi dhe ministri i Energjetikës, Damian Gjiknuri, të cilët ishin dje në Budapest, ku morën pjesë në punimet e takimit të "Nisma 16+1", platforma e bashkëpunimit midis Kinës dhe 16 vendeve të Europës Qendrore e Lindore. Thellimi i bashkëpunimit synon të tërheqë investime të rëndësishme në fushën e transportit e infrastrukturës.



SALI BERISHA
Ish-kryeministri Sali Berisha shprehu dje keqardhjen se raportet Kosovë-Shqipëri kanë mbetur në nivelin e vitit 2013. Në një postim në "FB", Berisha shkroi dje: "Shqipëria kanabiste e Noriegës, hipotekë negative për Kosovën dhe mbarë shqiptarët! Me gjithë takimet e përbashkëta ndërqeveritare të përvitshme, marrëdhëniet e gjithanshme midis dy vendeve kanë mbetur në nivelin e vitit 2013, madje ato kanë njohur edhe zbythje dhe probleme, të krijuara që më javën e parë në pushtet të Edvin Fasadës", tha Berisha.

qiptare, kosovarëve, kryeministri Rama deklaroi se, "unë jam i të njëjtit mendim me Presidentin tonë të Republikës dhe nuk kam asgjë për të shtuar qëndrimin të tij zyrtar për sa i përket kësaj çështjeje". Rama nuk i dha përgjigje pyetjeve për kryeprokurorin e ri, duke sqaruar se ajo nuk kishte qenë çështje e tryezës midis dy qeverive. Nga ana e tij, krye-

kemi ato dallime. Pra, përgjigja ndaj gjyqësorit, kundërshtimi politik është një temë; përgjigja ndaj gjyqësorit është një temë. Mendoj që Kosova po dëshmon se gjyqësori është i kredibël dhe shumë vendime të gjyqësorit në këto kohë, po i quaj, kanë dalë të drejta e të duhura dhe unë nuk mund t'i komentoj ato", u shpreh Haradinaj. "Kosovën e presin shumë sfida, mirëpo janë sfida që burojnë nga vetë specifikat e Kosovës. Ne rrugëtimin tonë më tutje, rrugëtimin euroatlantik e shohim të lidhur ngushtë me Republikën e Shqipërisë dhe e falënderojmë edhe njëherë kryeministrin Rama dhe të gjithë qeverinë për gatishmërinë për një bashkëpunim të tillë konkret dhe për marrëveshjet e arritura së bashku", u shpreh Haradinaj.



Mallrat me destinacion Kosovën do të kryejnë procedurat doganore në portin e Durrësit

Kryeministri Edi Rama lajmëroi dje se do të vijojë puna për hapjen e Zyrës Operacionale të Doganës së Kosovës në Portin e Durrësit dhe kjo do të thotë që do të jetë operative për pak javë. Ministrinë e Punëve të Jashtme, të Financave dhe Autoritetet Doganore të dy vendeve tona janë në bashkëpunim të vazhdueshëm në funksion të konkretizimit të këtij projekti brenda një kohe sa më të shkurtër. Sipas kreut të qeverisë, hapja e kësaj zyre do të ndikojë dukshëm në lehtësimin e shkëmbimeve tregtare të Kosovës me vendet e tjera. "Vetëm gjatë periudhës janartor 2017 rreth 120 mijë tonë mallra të përpunuara në portin e Durrësit u përkasin eksport-importeve transit me Kosovën. Eksportet transit nga KS përbëjnë 11% të volumit të mallrave të përpunuara në këtë port, ndërsa importet transit për në KS 10%", shpjegoi kryeministri. "Mallrat me destinacion Kosovën do të kryejnë të gjitha procedurat doganore në Portin e Durrësit, pa pasur nevojën e ndalesave të tjera në pikat doganore me Shqipërisë dhe Kosovës. Kjo shkurton në mënyrë drastike kohën për kryerjen e procedurave, ul kostot e mallrave dhe rrit përfitimet tregtare. Rrjedhimisht, tregu i Kosovës rrit atraktivitetin e tij për mallrat nga jashtë, duke mundësuar diversifikimin e vendeve nga të cilat importohet", tha Rama.

Gazetari nga Kosova i kujton marrëveshjet e pazbatuara Replikat me Ramën: Patët telashe me patatet, kryeministri: Janë zbatuar

Në konferencën e përbashkët të dy kryeministrave të Shqipërisë dhe Kosovës, një prej gazetareve kosovarë u kujtoi kryeministrave marrëveshjet e nënshkruara, por të pazbatuara mes dy vendeve. Kryeministri Rama tha se nuk ka asnjë marrëveshje të pazbatuar, por gazetari këmbënguli duke i kujtuar ato që i quajti "telashe me patatet e Kosovës".

REPLIKAT
Gazetari: U arritën sot 12 marrëveshjet dhe e përmendët rëndësinë e tyre, por kemi marrëveshje që



janë arritur edhe nga mbledhjet e kaluara, por që nuk janë zbatuar në tërësi. Jeni zotuar sot, që të gjitha këto marrëveshjet e arritura do të implementohen.
Kryeministri Rama: Më

thuj një që s'është zbatuar.
Gazetari: Për shembull, shkëmbimi i mallrave, ka mjaft telashe tek patatet.
Kryeministri Rama: Janë dy gjëra të ndryshme dhe marrëveshjet janë zbatuar. Sigurisht që ka nevojë për të bërë më shumë, prandaj kemi bërë edhe marrëveshje të reja, por nuk ka marrëveshje të pazbatuara. Janë dy gjëra të ndryshme. Telasheet tek patatet janë telashe të vjetra, që janë më pak sot se dje, por duhet të jenë zero nesër në krahasim me sot.

ZGJEDHJET AKUZAT

Kreu i PD: Mbi 20% të votuesve iu ofruan para për blerjen e votës

Basha: Qeveria antimafie, garanci për reformën e re zgjedhore

"Skandali, kush fshihet pas 3 inceneratorëve"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha apeloj dje për krijimin e një qeverie antimafie si garante e votës së lirë të shqiptarëve. Z.Basha reagoi përmes rrjetit "Facebook" për fenomenin e shitblerjes së votës. Sipas një studimi të financuar nga Bashkimi Europian, është zbuluar se të paktën një të pestës së votuesve iu është ofruar para ose favore në shkëmbim të votës. Basha deklaroi se krijimi i një qeverie antimafie që i hap rrugë një reforme të mirëfilltë zgjedhore. Kryedemokrati Lulzim Basha me anë të një statusi në "Facebook" denoncon blerjen masive të votave në zgjedhjet e 25 qershorit. Duke iu referuar një studimi të BE, Basha shprehet se 20% e votuesve pranojnë që iu është ofruar para në shkëmbim të votës. "Në Shqipëri votat janë blerë në mënyrë masive. Një studim i financuar nga BE ka zbuluar se mbi 20 për qind të votuesve iu është ofruar para ose favore në shkëmbim të votës. Numri i vërtetë është edhe më i madh, po të kihet parasysh se shumë persona zgjedhin të mos e tregojnë këtë të vërtetë", tha z.Basha.



STUDIMI

Sipas një studimi të financuar nga Bashkimi Europian, është zbuluar se të paktën një të pestës së votuesve iu është ofruar para ose favore në shkëmbim të votës.

SHITBLERJA

"Në Shqipëri votat janë blerë në mënyrë masive. Një studim i financuar nga BE ka zbuluar se mbi 20 për qind të votuesve iu janë ofruar para ose favore në shkëmbim të votës. Numri i vërtetë është edhe më i madh, po të kihet parasysh se shumë persona zgjedhin të mos e tregojnë këtë të vërtetë", tha z.Basha.

"Përballje shifrash, faktesh dhe provash"

Ahmetaj, Bashës: Përgjigju për 1 mln dollarët

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj reagoi dje pas akuzave të bëra nga kryedemokrati Basha. Ahmetaj deklaroi se kreu i PD "Ka raport problematik me realitetin dhe me shifrat". Ai shprehet se kreu i PD duhet të përgjigjet për burimin e financimit të parave që janë përdorur për lobim në SHBA. "Ndërkohë që gjuan në ajër një shifër kolosale, të përafërt me atë për të cilën i iku prokurorisë nga duart me raport mjekësor, Lulëzim Basha nuk e fsheh dot, mesa duket, shqetësimin në rritje për faktin se zullumi i 1 milion dollarëve mund të mbyllet



“

PËRBALLJA

"Në seancën e radhës në Kuvend, Bashën e pres me kënaqësi në një përballje shifrash, faktesh dhe provash, qoftë për luftën kundër plehrave të lëna rrugëve nga qeveria e tij e vjetër, qoftë për 1 milion dollarët e zinj për të bërë pleh Shqipërinë", tha Ahmetaj.

mbase në Shqipëri me një tjetër raport mjekësor, po zor se do mbyllet, andej nga ana tjetër e oqeanit ku nuk 'i fal njeri lojërat kukafshehtas me paranë. Në seancën e kësaj jave në Kuvend, Lulëzim Bashën e pres me kënaqë-

si në një përballje shifrash, faktesh dhe provash, qoftë për luftën kundër plehrave të lëna rrugëve nga qeveria e tij e vjetër, qoftë për 1 milion dollarët e zinj për të bërë pleh Shqipërinë", theksoi ministri Ahmetaj.

krimi"-, deklaroi z.Basha. **AFERA** Kryedemokrati Lulzim Basha denoncoi dje atë që e quan skandalin e ndërtimit të tre inceneratorëve në Elbasan, Fier dhe Tiranë. Në një deklaratë për mediat, Basha foli me emra dhe theksoi se Edi Rama dhe Arben Ahmetaj qëndrojnë

mbrapa ndërtimit të tyre. Sipas tij "200 milionë euro paguhen nga buxheti i shtetit për projektet kriminale të djegies së plehrave duke përdorur paratë e shqiptarëve kundër shëndetit të tyre". "Inceneratorët janë shkatërrues për shtetin. Projekte të inceneratorëve janë zbuluar si afera kor-

ruptive dhe kriminale. Mediat kanë zbuluar dhe kanë venë në dispozicion dhe shihet që janë një i njëjti person. Duket qartë që pronarët e vërtetë janë Arben Ahmetaj dhe Edi Rama. 4.8 milionë euro i kanë dhënë për inceneratorin e Fierit pa filluar asnjë punë. Në total janë 400 milionë euro që do



Presidenti i Republikës Ilir Meta, dje në Gjilan

Berisha, thirrje shqiptarëve: Ngrihuni në revolucion

Ish-kryeministri Sali Berisha duke reaguuar pas studimit të fundit të bërë për vendin tonë nga BE, që konstatonte se 20% e votuesve iu është ofruar para për blerje vote, u kërkoi shqiptarëve ve të ngrihen në revolucion. "Një studim që bën thirrje për revolucion! BE: "20% të votuesve në Shqipëri iu ofrua blerja e votës, mjaftueshëm për të ndryshuar rezultatit". Të dashur miq, një studim i Bashkimit Europian ka gjetur se në Shqipëri 20% e votuesve morën ofertë për blerjen e votës. Kjo shifër është e mjaftueshme për të përmbytur çdo rezultat, thotë studimi. Ky studim dëshmon se në Shqipëri demokracia ka vdekur, zemra e saj, vota e lirë ka ndaluar së rrahuri. Ky studim është një thirrje, është një kushtim për mbarë shqiptarët të ngrihen me guxim dhe vendosmëri në një revolucion demokratik për të përmbytur këtë klikë që asgjësoi në Shqipëria votën e lirë", shkruan ish-kryeministri Berisha në "Facebook".

Hafizi, Blushit: T'i s'mund të uzurposh LIBRA-n

Ish deputetja Mimoza Hafizi, i bëri dje të qartë Ben Blushit se nuk do të mund të uzurpojë LIBRA-n. Pasi në media u publikuan mesazhe që tregonin se mes dy bashkëthemeluesve të LIBRA-s Ben Blushit e Mimoza Hafizit ka pasur mosmarrëveshje që sollën edhe një ndarje mes tyre, vetë zonja Hafizi sqaron gjithçka. Me anë të një statusi në "Facebook" ajo shprehet se është Blushi ai që ka uzurpuar LIBRA-n duke mos e pozicionuar qartë në opozitë, duke mos luftuar për qëllimet që u krijuan më 1 nëntor të një viti më parë, duke i shpallur kështu luftë të hapur. "Në këtë situatë të vështirë edhe për mua, miq të mirë më kanë sugjeruar largimin nga ajo çka mbetur prej organizatës sonë. E kam menduar gjatë, por më duket një zgjidhje e padenjë për mua që nuk i jam shmangur asnjëherë betejave për të vërtetën. As kësaj të fundit, për t'ju treguar që z. Blushi nuk përfaqëson më asgjë nga LIBRA që themeluan me 1 nëntor të vitit të kaluar. Tentativa e tij uzurpuese dhe ekuilibri i tij etik po e çojnë drejt greminës projektin që ngritëm me aq mund e dashuri", shprehet znj. Hafizi.

të shpenzohen për 10 vitet e fundit. Bëjnë një kontrast me privatizimin dhe privatizimin nuk merr asnjë risk. Po përpiqen të bëjnë një në Korçë, një tjetër në Rrogozinë ku të gjitha janë ngritur në protestë. Po fshehin pronarët e vërtetë. Është një aferë kriminale një aferë mafioze. I bëj thirrje Kontrollit të

Lartë të Shtetit që të fillojë hetimet për këtë rast. Është faqja tjetër e medaljes së kanabizimit të Shqipërisë. Me kanabis është eksporti, ndërsa me inceneratorët do të importohen me mbetje. Duhet të nisim me njëherë hetimet, pasi po dëmtohet shëndeti i njerëzve", deklaroi Basha.



Valentina Madani

Presidenti i SHBA-ve, Donald Trump u dërgoi urim për rastin e 105-vjetorit të Pavarësisë. Në një mesazh drejtuar Presidentit Ilir Meta, kreu i Shtetësisë së Bardhë thotë se SHBA bashkohet me urimin për popullin shqiptar. Trump shkruan se dy kombet kanë zhvilluar një bashkëpunim të thellë për çështje me rëndësi globale. Donald Trump ka një mesazh edhe për reformën në drejtësi dhe zbatimin e saj nga institucionet shqiptare, e cila është kyçe për integrimin në BE. Duke vlerësuar marrëdhëniet mes dy vendeve, Trump falënderon Shqipërinë për mbështetjen që i ka dhënë SHBA në luftën kundër terrorizmit, si një vend aleat i NATO-s. Presidenti Trump shprehet se SHBA ka mirëpritur zbatimin nga ana e Shqipërisë të reformave kyçe të drejtësisë, të cilat e kanë sjellë vendin më afër qëllimit për të hyrë në Bashkimin Evropian. "I dashur zoti President, ndërsa ju festoni 105-vjetorin e Pavarësisë më 28 Nëntor, populli i Shteteve të Bashkuara më bashkohet në urimin për popullin shqiptar. Në këtë ditë ne konfirmojmë miqësinë tonë të fortë dhe përkushtimin ndaj Shqipërisë si dhe presim që ta fuqizojmë edhe më tej këtë marrëdhënie gjatë viteve të ardhshme. Dy kombet tona kanë zhvilluar një bashkëpunim të thellë, që na ka lejuar të punojmë së bashku për të trajtuar çështje me rëndësi globale. Ju falënderojmë për rolin tuaj si partner vendimtar në promovimin e qëndrueshmërisë rajonale dhe luftën kundër ekstremizmit, si dhe mbështetjen tuaj anembanë botës si një aleat i NATO-s dhe vend anëtar i koalicionit për shkatërrimin e ISIS-it. Këtë vit mirëpritëm zbatimin nga ana e Shqipërisë të reformave kyçe të drejtësisë, të cilat e kanë sjellë vendin më afër qëllimit për të hyrë në Bashkimin Evropian dhe bashkëpunimit më të madh rajonal. Ne e lavdërojmë përparimin që ka shënuar Shqipëria në drejtim të integritetit euroatlantik dhe të sigurimit të paqes e begatisë për të gjithë shqiptarët", shkruan presidenti Trump në mesazhin drejtuar homologut shqiptar, Ilir Meta. Trump e mbyll mesazhin e tij duke thënë: "Jemi bashkë me ju teksa festoni këtë ditë të veçantë dhe iu uroj ju dhe popullit shqiptar gjithë të mirat gjatë vitit të ardhshëm!".



Thaçi dhe Meta në Gjilan, përurojnë e shtatoren e Idriz Seferit

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ishte dje i pranishëm në komunën e Gjilanit në Kosovë, ku në prag të festave mbarëkombëtare të nëntorit u zbulua shtatorja e Idriz Seferit, heroit të kauzës kombëtare shqiptare. Në Gjilan, Presidenti Meta u prit nga Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe zyrtarët komunalë. Gjatë fjalës së tij, Meta tha: "Jemi vërtet dy shtete, por jemi një komb shqiptar i pandarë dhe i bashkuar si asnjëherë tjetër më 28 Nëntor. Gjilani u shqua në të gjitha luftërat, kur bëhej fjalë për lirinë e Shqipërisë dhe të shqiptarëve, duke kundërshtuar të gjitha përpjekjet kundër shqiptarëve, për ndarjen e territoreve të tyre". Më pas, kreu i shtetit shqiptar recitoi disa vargje të shkurtër, që i entuziazuan së tepërmi njerëzit e pranishëm, të cilët nisën të brohorisin. "Kaçanik o shka mb e gur. Vritesh e pritësh për flamur! Për flamurin e Skënderit luftojnë djemt e Idriz o Seferit!" - ishin vargjet e cituara nga Meta.

105-vjetori i Pavarësisë, presidenti amerikan mesazh për shqiptarët

Trump, Metës: Reforma e drejtësisë e ka sjellë Shqipërinë më afër BE

"Marrëdhënia SHBA-Shqipëri do të fuqizohet"



Presidenti i SHBA-ve, Donald Trump

Sekretari i Shtetit Tillerson: Përgëzohet qeverinë për reformat

Në emër të popullit të Shteteve të Bashkuara i përcjell urimet më të mira popullit të Shqipërisë teksa festoni 105 vite pavarësi. Shqipëria është një vend mik dhe aleat i vyer dhe Shtetet e Bashkuara, presin me kënaqësi përparimin tuaj të vazhduar drejt integritetit më të madh euroatlantik dhe anëtarësimit në BE. Vlerësojmë thellësisht kontributet e Shqipërisë në NATO dhe në koalicionin për mposhtjen e ISIS si dhe promovimin nga ju të stabilitetit në rajon. Përgëzohet Qeverinë e Shqipërisë për përpjekjet e saj të vazhduara për të vënë në zbatim reforma kyçe, përfshi reformën në drejtësi, luftën kundër krimit të organizuar.

Meta: Duhet bashkëpunim më i ngushtë Serbi-Shqipëri

Presidenti Ilir Meta deklaroj dje për TV "Klan" se ka ardhur koha që Shqipëria dhe Serbia të kenë një bashkëpunim më të ngushtë dhe konkret dhe të mos përsëriten retorikat nacionaliste.

Z.President, është hera e parë në Medvegjë që shprehët optimizëm për tuaj këtu. Pse ishte gjithë ky optimizëm?

Faleminderit që edhe ju keni bërë gjithë këtë rrugë për të qenë sot këtu dhe për të pasqyruar edhe këtë vizitë. Besoj se ka arsye për të pasur optimizëm, kur shohim këtë bashkëpunim midis serbëve dhe shqiptarëve këtu në Medvegjë. Këtë mikpritje të përbashkët, por edhe këtë angazhim të përbashkët për të forcuar bashkëpunimin, për të forcuar bashkëjetesën dhe për të parë drejt së ardhmes, në mënyrë që kjo komunë të ketë perspektivë dhe të mos braktiset më as nga serbët dhe padyshim, as nga shqiptarët.

Cfarë mund të bëhet konkretisht për Medvegjën? Takuat edhe përfaqësuesit e shqiptarëve këtu, cilat ishin premtimet nga Tirana?

Ne kemi pasur një takim shumë të përzemërt edhe me drejtuesit e pushtetit vendor, si përfaqësuesit serbë, kryetari i komunës apo kryetari i këshillit të komunës, ashtu edhe nga përfaqësuesit shqiptarë, nënkryetarja e komunës, znj. Leme Xhema dhe përfaqësuesit shqiptarë në këshillin e komunës dhe kemi rënë d



kord për të rritur shkëmbimet midis Komunës së Medvegjës dhe institucioneve në Shqipëri dhe bashkive të Shqipërisë. Unë e kam ftuar kryetaren e komunës, nënkryetaren dhe të gjithë këshillin për një vizitë në Shqipëri, në mënyrë që të bëjmë një kalendar për të ardhmen. Jam ftuar nga drejtuesit e komunës për të marrë pjesë në aktivitetet kulturore që bëhen këtu në këtë komunë, në mënyrë të veçantë ato që organizojnë shqiptarët, ku vjen edhe diaspora. Aktivitetet kulturore që synojnë të mbajnë gjithnjë të gjalla traditat e shqiptarëve këtu, por edhe në aktivitetet e ndryshme, ashtu sikurse të njëjtën gjë kam bërë edhe unë për t'i ftuar, për të qenë më prezent në Shqipëri, në mënyrë që ne të japim një mesazh të fortë që Komuna e Medvegjës të jetë një shembull i bashkëpunimit, i bashkëjetesës midis shqiptarëve dhe serbëve dhe të gjithë rajonin tonë. T'i inkurajojmë shqiptarët të

vazhdojnë të qëndrojnë këtu, por edhe të shikojmë çdo mundësi që jep impulse të zhvillimit ekonomik, bazuar në resurset e kësaj komune dhe në dashurinë e njerëzve për vendin, për truallin e të parëve të tyre.

Shqiptarët në Serbi e konsiderojnë veten ende si pa të drejta. Kanë probleme me librat apo me shumë gjëra të tjera. Kjo vizitë mund t'i shtojë rëndësinë e të drejtave të tyre. A mund të thuhet se ka përmirësime? Keni qenë edhe si ministër i Jashtëm në Serbi...

Besoj se ka vend për të ecur drejt përmirësimit në të dyja drejtimet. Në radhë të parë, unë do të theksoja rëndësinë e përmirësimit të bashkëpunimit midis vetë shqiptarëve në Luginën e Preshevës dhe së dyti, midis shqiptarëve të Luginës së Preshevës dhe institucioneve të Serbisë. Në këto dy drejtime ka vend për përmirësime, por fakti që sot unë jam në Medvegjë edhe si President i Shqipërisë, ju vetëm kaq, por fakti që jam pritur edhe pse është ditë e diel, me shumë respekt edhe bujari edhe nga drejtuesit serbë të Medvegjës, përveç drejtuesve dhe përfaqësuesve shqiptarë, padyshim që tregon se ka një vullnet pozitiv ka një dëshirë për ta shndërruar Medvegjën për të ardhmen në një komunë model të bashkëjetesës, të harmonisë, të zhvillimit, të respektimit të të drejtave të njeriut dhe unë besoj se kjo gjë do të ndodhë.

Gjithmonë kur flitet Serbi-Shqipëri natyrisht në mes është çështja e Kosovës. A do ta vizitoni edhe Beogradin pas kësaj vizite këtu?

Unë Beogradin e kam vizituar prej shumë kohësh, prej dy dekadash. Kur nënkryetarja e komunës tha që unë kisha punuar për paqen në rajonin prej 'shekujsh', e vlerësova si një lapsus, por më pas kur u bë sqarimi se konsiderohej angazhim i im edhe para vitit 2000 dhe pas vitit 2000, kjo mund të konsiderohej një thënie, e cila ka një të vërtetë. Unë besoj shumë të sfida e vërtetë që kanë shqiptarët dhe serbët në mënyrë të veçantë, por i gjithë rajoni, që është pikërisht përpjekja për të fituar kohën e humbur. Koha e humbur nga konfliktet nga retorikat nacionaliste, nga populizmi i liderëve mund ta fitohet vetëm përmes një bashkëpunimi të ngushtë dhe konkret. Është koha për të realizuar bashkëpunime konkrete dhe jo për të përsëritur retorikat nacionaliste. Njerëzit kanë nevojë për shpresë, kanë nevojë për besim, së fundmi të tyre mund të rriten në Medvegjë, mund të rriten në Bujanovc, mund të rriten në Preshevë, në zona të tilla dhe kjo është një sfida që ne duhet ta fitojmë në emër të kësaj të ardhmeje. Përndryshe këto zona do të vazhdojnë të braktisen dhe jam i sigurt që askush nuk do të ndihet i fituar.

Buxheti 2018, Komisioni i Ekonomisë kalon kërkesat e institucioneve

Punonjës dhe para, ja cilët përfitojnë nga Kuvendi të SHISH

Miratohet projektbuxheti dhe paketa fiskale

Ornela Manjani

Miratohen fondet shtesë në fonde dhe shtim të numrit të punonjësve për Presidencën, Kuvendin, SHISH, Ministrinë e Drejtësisë, KLSH-në Ministrinë e Jashtme dhe Zyrën e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor. Komisioni për Ekonominë dhe Financat miratoi propozimet e bëra nga komisionet parlamentare për rishikim të fondeve dhe punonjësve në buxhetin e vitit 2018, duke dhënë aprovimin për disa kërkesa të institucioneve kryesore në vend. Shtesat u miratuan për Kuvendin, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Gjykatën Kushtetuese, Ministrinë e Drejtësisë apo Presidencën. Për Kuvendin u miratua një shtesë në organikë për 5 punonjës si dhe në zërin e shpenzimeve një fond prej 141 milionë lekë. Këto të fundit do të shkojnë për paga të punonjësve shtesë, për realizimin e një botimi të posaçëm për reformën në drejtësi si dhe për udhëtime e dieta. Po kështu 90 milionë lekë do të jenë në dispozicion për blerjeje autovetura, rikonstruktion bar-restorant, blerjeje dhe montim ashensori në sallën plenare, aplikacioni Kuvendi in Shqipërisë si dhe disa shpenzime të tjera. Kontrolli i Lartë i Shtetit nga ana tjetër, kërkoi 5 punonjës më shumë në organikë si dhe 14 milionë lekë shtesë. Po kështu të rishikohen fondet duke rritur shpenzimet për personelin dhe duke ulur ato për investimet. Ministria e Drejtësisë kërkoi 25 punonjës shtesë si dhe 20 milionë lekë më shumë për të përballuar shpenzimet me paga të tyre. Presidencë kërkoi 30 milionë lekë më shumë dhe pas saj edhe Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor me 32 milionë lekë. Gjykata Kushtetuese, Inspektorati i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Shkolla e Magjistraturës të gjithë kërkuan më shumë para. Ndërkohë buxheti të Qendrës Kombëtare e Rehabilitimit të të Verbërve u shtuan 40 milionë lekë kurse për invalidët e punës u miratua indeksimi i pagës një fond që shkon në 200 milionë lekë. Ministria e Jashtme mori më shumë para për programin e regjistrimit të shqiptarëve jashtë shtetit me 35.5 milionë lekë si dhe rritje për shpenzimet e personelit me 113 milionë lekë. Edhe Shërbimi i Brendshëm Informativ do të ketë 33 punonjës më shumë si dhe 560 milionë lekë më shumë.



Komisioni i Ekonomisë

SHTESA E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE FONDEVE

- Kuvendi 5 punonjës 141 milionë lekë
- Kontrolli i Lartë i Shtetit 5 punonjës 14 milionë lekë
- Ministria e Drejtësisë 25 punonjës 20 milionë lekë
- Presidencë 30 milionë lekë
- Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor 32 milionë lekë
- Qendra Kombëtare e Rehabilitimit të të Verbërve 40 milionë lekë
- Ministria e Jashtme, për shpenzimet e personelit me 113 milionë lekë.
- Shërbimi i Brendshëm Informativ 33 punonjës 560 milionë lekë

Nga kjo 441.7 milionë lekë shkojnë në zërin e investimeve ku peshën më të madhe e zë blerja e sistemit të grumbullimit dhe analizës së informacionit me një vlerë prej 275 milionë lekë apo rreth 2 milionë euro.

TAKSA MBI PRONËN

Në komision është diskutuar edhe një herë taksa mbi pronën, e cila nga 1 janari i vitit të ardhshëm do të llog-

aritet në bazë të vlerës së tregut. Sipas amendimeve që iu bënë projektligjit të përgatitur nga ekspertët e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe të miratuar nga qeveria, komisioni pranoi dje që në seancën plenare, ku do të diskutohen nënën nën të gjitha draftet e Paketës Fiskale, sa i përket ndryshimit të taksimit mbi banesat, që përjashtohen

kategoritë e kryefamiljarëve, që përfitojnë pension pleqërie, ose social, që janë me banim në fshat, ose qytet kur familja përbëhet vetëm nga pensionistë. Po kështu, nuk do të taksohen ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike, si dhe kryefamiljarëve me aftësi të kufizuara. Po kështu, do të përfitojnë një lehtësim të tillë edhe ndërtesat e kryefamiljarëve që përfitojnë pension invaliditeti shtetëror dhe pension invaliditeti të plotë në fshat dhe nuk kanë anëtarë të familjes të punësuar, ose të vetëpunësuar. Mendohet se këto kushte i plotësojnë rreth 60 mijë familje në fshat e qytet. Nga përlogaritjet e bëra, rezultojnë që të paktën 36 për qind e stokut të banesave do të përjashtohen nga detyrimi fiskal.

DEVIJON NË DISKUTIME E DEBATE TË ASHPRA MES DEPUTETËVE

Erjon Braçe dhe Edmond Spaho janë përfshirë në debate të ashpura në kohën që po diskutohet për taksën mbi pronën. Debatu ka marrë tjetër rrjedhë, kur Braçe ironizoi bashkimin e PD me LSI, teksa tha se tani PD është martuar me një tjetër forcë politike.

EDMOND SPAHO: Ai ministri rrogën e 30 vite të ketë mbledhur nuk e bien dot tokën. Ndaj duhet të fillojë hetimi pasuror.

ERJON BRAÇE: Do ta dënoj me çdo gjë. Ky rast do të ndëshkohet me përgjegjësi penale.

EDMOND SPAHO: Këto janë skandalozë.

ERJON BRAÇE: Nuk do luajmë lojën e PD, që tani është martuar me një tjetër forcë politike.

EDMOND SPAHO: Po lëri këto, po ti kur u martove.

ERJON BRAÇE: Thashë bashkëjetesë.

TABAKU-BUSHATI: Mos u shqetëso për PD, por ju duhet të mbledhni mendjen.

ERJON BRAÇE: Spaho tha se duhet të largohen edhe 8 drejtorë të tjerë, teksa ka ngritur pyetjen se pse u larguan ish-oficerët e Vlorës.

EDMOND SPAHO: Sa për agjencitë, praktika ka treguar që nuk kanë kapur asnjë rast. Kur i referohemi fakteve të agjencisë referuar në organin e prokurorisë, i cili, më lejoni të them, se nuk ka kryer asgjë për këtë i kapin ata, por puna është të kapin ata që janë sipër.

ERJON BRAÇE: Dakord po flisim për rezultatet

ERVIN BUSHATI: Më vjen keq që opozita nuk ka asnjë argument. Pse thoni vetëm për drogën, po krimin dhe armët?

EDMOND SPAHO: Të gjitha bashkë, droga, trafikimi, armët.

ERVIN BUSHATI: Nuk keni pse stigmatizoni një proces për një industri që nuk ka filluar të ekzistojë.

EDMOND SPAHO: Ato zgjedhjet që i bleve me para. Dhe, nëse nuk ka kontroll, prandaj kanë kaluar paratë e pakapura. Këtë nuk ta them unë, por po ta thotë OSBE-ODIHR. Ndërtimi dhe turizmi janë të parët pastaj vjen funksioni bankar.

ERVIN BUSHATI: Pse paragjykon? Unë nuk po e përmend PD kur lobon me para.

EDMOND SPAHO: Merrni Sajmirin dhe ata tjerë hipni në BWV dhe kontrolloni ku duhet kontrolluar.

ERVIN BUSHATI: Ishte Audi

EDMOND SPAHO: Zonja Kushi, kur nuk paska krim dhe drogë pse ikën ata drejtorët? Janë edhe nja 8 të tjerë që do ikin në mos kanë ikur.

NDREU: Si thoni ju që pastrohen këto para. Në cilin vend të botës paratë e pista që ekzistojnë kudo i kalojnë buxheti si pastrim parash. Kush e thotë që kur flitet për buxhetin, ne duam të pastrojmë para. Nëse hoteleria është përdorur dikur në një shtet për këtë punë, do përdoret edhe këtu, nuk ka për të ndodhur.

EDMOND SPAHO: Zoti Ndreu, dakord që krim ka kudo edhe në Amerikë, por ministër të Brendshëm përzier me drogën vetëm në Shqipëri dhe Kolumbi ka.

ERJON BRAÇE: Debatu për këtë pikë mbyllet këtu. Propozimi që ka bërë zoti Bushati, nuk ka lidhje fare me këtë pikë. Nuk e kuptoj si mund të bëhet pastrim parash me turizëm, kur ky vend ka vetëm 1 muaj turizëm.


JORIDA TABAKU: Kjo nuk ka ndodhur asnjëherë si këtë herë.

ERJON BRAÇE: Ju bëra thirrje disa herë të mos i bëjmë në komisionin e ekonomisë këto debate. Po flisim për dy gjëra që nuk kanë lidhje me këtë çështje.

EDMOND SPAHO: Keni të drejtë që qenë kryeministri i vendit që ai shkente në çdo fshat dhe pyeste se si po ia çoni me drogën.

Biznesit të pijeve energjike u hiqet akciza Aktualisht paguajnë 30 lekë/litër

Qeveria pritet të heqë akcizën për pijet energjike. Propozimi, që ka kaluar miratimin e komisioneve parlamentare, pritet të kalojë edhe hallkat e tjera, do të bëjë që këto biznese të kenë zero akcizë. Propozimin në Kuvend e ka dorëzuar deputeti Ervin Bushati, i cili ka propozuar që të shfuqizohen disa nene nga ligji për akcizat dhe konkretisht ato që lidhen me pijet energjike. "Kreu IX/1 "Pijet energjike" dhe nenet 77/1 "Përkufizime" dhe 77/2 "Detyrimet" shfuqizohen. Ky ndryshim reflektohet edhe në shtojcën nr.1 që i bashkëlidhet ligjit duke hequr emërtimin dhe nivelet treguese të akcizës për pijet energjike"-thuhet



në propozimin e bërë nga deputeti socialist Ervin Bushati dhe që ka kaluar miratimin në Komisionin e Ekonomisë dhe Komitetin e Partisë Demokratike refuzuan të merrnin pjesë. Akciza të pijet energjike duket të jetë taksa që i ka rezistuar më pak presionit të lobeve duke qenë se qëndroi në fuqi vetëm për pak vite. Qeveria e majtë e vendosi këtë taksë në vitin 2014 duke taksuar çdo litër pije energjike 50 lekë dhe më pas u ul në 30 lekë.

Prova e madhe që pret Ramën dhe kërkesat e LSI

Pas mbledhjes së Grupit të Lëvizjes Socialiste për Integritim, kreu i këtij grupi, Petrit Vasili, theksoi edhe një herë idenë se kjo parti është kundër disa prej vendimeve të projektligjit të buxhetit dhe paketës fiskale. Vasili tha se Rama dhe qeveria e tij duhet të tregohen më të dhembshur përballë popullit të varfër dhe jo ndaj oligarkëve që sipas tij, e ndihmuan PS-në në zgjedhje. Kreu i grupit të LSI, tha se në seancën e së enjtes qeveria duhet të tregojë se anën e kujt mban. "Kjo do të jetë seancë e rëndësishme për qëndrimin përfundimtar, për një ndarje në raportin e qeverisë në njërin anë, dhe opozitës në krahuar tjetër. Amendamentet e LSI-së që janë paraqitur që i shkojnë në ndihmë të mijëra njerëzve të varfër, është një ndarje se ku do vendoset përfundimisht kjo qeveri. Është një qeveri mike e oligarkëve që e ndihmuan në zgjedhje, dhe armike e popullit të varfër. LSI ka kërkuar TVSH-ja për ushqimet bazë të zbrësë nga 20% në 5%. Këto artikuj të shportës janë artikuj bazikë për familjen shqiptare, ushqime pa të cilat populli shqiptar nuk bën dot. Qeveria do të tregojë dhembshuri ndaj qytetarëve, apo do t'i dhunojë përfundimisht ata. Do të vendosen në krahuar e oligarkëve apo popullit të thjeshtë, nuk duhet të tregohen kaq të egër me ta. Mijëra shqiptarë mbijetojnë falë bizneseve të vogla, por që, në fakt, janë mbijetesë, me njerëz që duan të ushqehen e shkollojnë fëmijët e tyre, nuk mund t'i përballojnë taksat e reja që do t'i vendosen", tha Vasili.

Ja kush janë dy skafistët nga Saranda, si iu vuri policia GPS në mjet

Arbër Sulo

GREQI/SARANDA

Operacioni antidrogë në Greqi, shkon në 11 numri i të arrestuarve

Biznesmeni grek dyshohet të jetë financues i organizatës

Policia greke vijon hetimet për arrestimin e çdo anëtarë të organizatës kriminale që transportonte drogë nga brigjet shqiptare. Në kuadër të këtij operacioni, mbrëmjen e së dielës në një hotel në Notia Proastia ka rënë në pranga një 50-vjeçar grek nga Mykono, pronar i dy restoranteve. Ai rezultoi të jetë një nga financuesit e organizatës së drogës. Arrestimi i 50-vjeçarit e çon në 11 numrin total të të arrestuarve, konkretisht 6 shqiptarë, 2 italianë, 2 grekë dhe 1 bullgar. Ndërkohë janë publikuar emrat e dy skafistëve nga Saranda, të cilët kryenin transportin e hashashit. Aksioni për arrestimin e grupit kriminal dhe sekuestrimin e 1.6 tonë drogë është përhëndetur edhe zv.ministri grek i Mbrojtjes, njëkohësisht deputet i SYRIZA, Nektarios Santorinos, i cili në një deklaratë për radion e Agjencisë telegrafike të lajmeve të Athinës, shprehet se ishte një sukses që nuk erdhi brenda 48 orësh, por pas një ndjekje të ngushtë të çështjes, përmes kryqëzimit të informacionit dhe nëpërmjet një pune të madhe që bënte krerët e Policisë Kufitare.

ARRESTIMET

Policia greke bën me dije së dy skafistët shqiptarë të arrestuar nga policia greke janë nga Saranda dhe rezultojnë persona me precedentë të mëparshëm penal. Policia ka publikuar emrat e tyre, të cilët së bashku me skafistin italian 62-vjeçar (i skeduar në trafik narkotikësh), kishin kryer transportin e hashashit nga Shqipëria me destinacion Italinë për të tretën herë radhazi. Bëhet fjalë për shtetasin Arban Baxheri, 32-vjeç dhe shtetasin me emrin Ervis, të dy nga Saranda. Gjatë operacionit mësohet se një nga sarandjotët është plagosur në shtatull nga të shtënat e snajperistëve. Bëhet me dije se policia greke kishte informacion prej kohësh për këtë grup, që dyshohet se me këtë gomone ka kryer të paktën tri rrugë trafiku Shqipëri-Greqi. Pasi bëhej transporti, mësohet se gomonia parkohej në Lavrio, aty ku policia ka arritur të vendosë një GPS. Nga Lavrio gomonia transportohej me trailer drejt Korfuzit ku hidhej në det për rrugën e radhës. Mësohet se gomonia ishte blerë 300.000 euro nga 62-vjeçari italian. Siç informojnë burimet, 10 ditë më



Biznesmeni grek, i dyshuar si financues i organizatës



Droga dhe sendet e sekuestruara gjatë operacionit

11

ARRESTIME

Gjatë operacionit antidrogë, policia greke ka arritur të kapë një gomone transoceanike të mbushur me 1.6 tonë marijuanë. Policia njofton se ka shkukur në 11 numri total i të arrestuarve, konkretisht 6 shqiptarë, 2 italianë, 2 grekë dhe 1 bullgar. Vetë mediat e huaja e quajtën këtë ngjarje si "Operacioni më i madh në historinë e policisë kufitare greke".



Operacioni antidrogë në Greqi

OPERACIONI

ZV. MINISTRI GREK I MBROJTJES

Aksioni për arrestimin e grupit kriminal dhe sekuestrimin e 1.6 tonë drogë është përhëndetur edhe zv. ministri grek i Mbrojtjes, njëkohësisht deputet i SYRIZA, Nektarios Santorinos, i cili në një deklaratë për radion e Agjencisë Telegrafike të lajmeve të Athinës shprehet se ishte një sukses që nuk erdhi brenda 48 orësh, por pas një ndjekje të ngushtë të çështjes, përmes kryqëzimit të informacionit dhe nëpërmjet një pune të madhe që bënte krerët e Policisë Kufitare.



të tjera. Policia greke, e cila e ka konsideruar këtë një nga operacionet më të mëdha të rojeve bregdetare.

parë pjesëtarët e grupit kanë bërë një sherr në Korfuz, por kur ka shkukur policia janë shpërndarë. I njëjti grup dyshohet se i vit me parë ka humbur një ngarkesë droge me vlerë rreth 100.000 euro e cila është kapur nga policia. Sa i përket drogës, burimet bëjnë të ditur se ajo ishte e kultivuar në një zonë të Sarandës nga një prej pjesëtarëve të organizatës. Sakaq mësohet se policia greke kishte informacion prej kohësh për këtë grup dhe pas përfundimit të operacionit është informuar policia e Sarandës e cila ka kryer edhe kontrollin banesash ditën e djeshme. Në operacion morën pjesë forca speciale të marinës greke të pajisur me skafë të shpejtë një avion, helikopterë dhe snajperiste. Policia greke shpërndau dhe pamjet e operacionit, ku trafikantët gjatë ndjekjes hodhën në det sasi të tjera droge dhe armë. Gjatë kontrollave u sekuestrua edhe një tjetër gomone me 4 motorë nga 350 kuaj fuqi secili, disa armë dhe materiale

acionit është informuar policia e Sarandës e cila ka kryer edhe kontrollin banesash ditën e djeshme. Në operacion morën pjesë forca speciale të marinës greke të pajisur me skafë të shpejtë një avion, helikopterë dhe snajperiste. Policia greke shpërndau dhe pamjet e operacionit, ku trafikantët gjatë ndjekjes hodhën në det sasi të tjera droge dhe armë. Gjatë kontrollave u sekuestrua edhe një tjetër gomone me 4 motorë nga 350 kuaj fuqi secili, disa armë dhe materiale

Mediat italiane: Mbretëreshë e modës

Udhëtimet e luksit të Viola Spiros me të dashurin bos kokaine

TIRANE - Pas arrestimit pak ditë më parë të Valentin Selaj, i cili u cilësua si bos kokaine, është vënë në gendër të vëmendjes si në Shqipëri ashtu edhe në Itali, e dashura e tij, moderatorja e njohur Viola Spiro. Selaj është parë shpesh në udhëtime luksoze bashkë me Violën. Vetë moderatorja ka postuar foto në rrjetin social "Instagram". Viola Spiro shihet në Zvicër mes maleve me borë, në pishina të ngrohta. Por nuk kanë munguar as udhëtime në Paris, Santorini, Venecia etj. Mediat italiane e cilësojnë vajzën e ekranit shqiptar, si mbretëreshë mode që ishte mësuar me jetën e bukur: "Ajo nuk ka asnjë faj. Përveç se është e bukur dhe e zgjedhura e Valentin Selaj, një nga bosët e klanit të shqiptarëve shkatërruar nga skuadra policore fiorentine me ndihmën e kolegëve holandezë. Viola është një nga femrat më të famshme dhe më të pëlqyera në Shqipëri. E shohim shpesh në kopertina, bën rolin e aktores, modeles, prezantueses. Me pak fjalë një mbretëreshë mode që ishte mësuar me jetën e bukur, pa e kuptuar që i dashuri i saj shqiptar ishte një nga gjashtë të arrestuarit për kapjen e të cilit u vënë në lëvizje gjysma e policisë së Europës. Sa për operacionin, ajo s'ka të bëjë fare, por një ditë pas operacionit të policisë ku iu arrestua i dashuri postoi në rrjetet sociale ku ndiqet nga miliona njerëz, dy imazhe të trishtuara. "Që nga ai moment, ajo nuk buzëqesh më", shkruhej në një artikull të La Nazione.



SHIPALLJIE ANKANDI

Shoqëria Përmbartimore "Enforcement Group" sh.p.k. shpall ankandin e parë për pasurinë e paluajtshme të llojit Ndërtëse, me Nr. 213/33-ND, vëllimi 17, faqe 150, ZK 3976, me sipërfaqe 240.50 m² gdo kat, vitë 4 katëshe, adresë e pasurisë Shkozë, Tiranë, në pronësi të Remzi Adil Muça. Çmimi me të cilën del kjo pasuri në ankandin e parë është 60,028,800 (gjashtëdhjetë milion e njëzet e tetë mijë e tetëqind) lekë. Ankandi do të zhvillohet në ambientin e Shoqërisë Përmbartimore "Enforcement Group" sh.p.k. në adresën Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 1, Pallatet e Shoqërisë "Gora", Kati 3, Ap. 14, Tiranë në datën 30.11.2017, ora 16.00. Për kontakt: Cel: 0692087566; email: enforcementgroup2014@gmail.com

Njoftim për shitje me ankand

Sh. "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin për pasurinë e debitorit V Gjikas, P Gjikas. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga: "Apartment" me numër pasurie 31/202+1-6 faqe 160 Vol 44, në ZK 8602 me sipërfaqe 63.19 m² në Vlorë. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 32.890 Euro. Ankandi do të zhvillohet datë 07.12.2017 orën 15:00, sellin e shoqërisë "pall Gora" Bulv "Gj. Fishta" Kulla 3, Tiranë. Ofreruesit duhet të tregojnë dokumentacionin të kontaktuar me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit iir_dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com.

Shoqëria përmbartimore "AFA-2010" sh.p.k shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme:

Pasurisë me Nr.3/369 e llojit "Tullall + Banesë 3 katëshe" me sip. tullall 350 m², dhe sip. banese 191,9 m², (kati përdehe 191,9 m², kati i 1,269,03 dhe katili 269 m²) ndodhur në L. "11 Janari", ZK. 2310, Kuçovë në pronësi Agim Isa Zeqea. Çmimi fillestar në ankandin e tretë është 10,000,000 Lekë. Ankandi zhvillohet në datën 18.12.2017, ditën e Hënë ora 15.30 në ambientin e Shoqërisë Përmbartimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë. Për info. Tel:044503458 ose E-mail shoqeriafermbartimoreafa2010@gmail.com

Punonjësi i Gardës, Erion Musai, rëndë në spital. Policia: Të dëmtuarit, jashtë rrezikut për jetën

Aksidentohet eskorta e Ramës, plagosen tre gardistë

U përplasën 4 mjete, "Toyota" që shoqëronte kryeministrin ra në kanal

KORÇË

Dy makina të eskortës së kryeministrit Edi Rama janë aksidentuar në hyrje të qytetit të Korçës, ndërsa kanë mbetur të plagosur tre gardistë. Mësohet se ngjarja ka ndodhur pasditen e djeshme, rreth orës 14:00, në aksin rrugor Maliq-Korçë pranë fshatit Bulgarec, tekta mjetet po shoqëronin kreun e qeverisë për në mbledhjen e përbashkët me qeverinë e Kosovës. Burime zyrtare nga policia e qytetit juglindor bënë me dije se në aksidentin ku mbetën të plagosur tre punonjësit e Gardës së Republikës Klodian Llaka, Erion Musai dhe Shkëlqim Pojana janë përfshirë 4 automjete, ku njëra prej tyre (e eskortës) ka përfunduar në kanal. Të plagosurit janë dërguar urgjentisht në spitalin rajonal të Korçës, ku kanë marrë ndihmën e parë mjekësore. Ndërsa, njëri prej tyre, gardisti Ervin Musai është transportuar me helikopter në Tiranë për mjekim më të specializuar. Pas sinjalizimit për ngjarjen në fjalë, blutë dhe përfaqësues të prokurorisë kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për zbardhjen e plotë të shkaqeve të aksidentit.

AKSIDENTI

Sipas burimeve policore, në aksident janë përfshirë 4 automjete, ku dy të eskortës së kryeministrit (një "Toyota" dhe një "Mitsubishi" me targa të Ministrisë së Brendshme si dhe një mjet tip "Volkswagen" me targë AA 426 FD e një "Range Rover



Makina e eskortës së kryeministrit



Aksidenti i djeshëm në Korçë

er" me targë AA 313 DX. Paraprakisht mësohet se mjeti tip "Volkswagen", i drejtuar nga Spiro Naçi, që

udhëtonte në krah të kundërt me eskortën, duke mos respektuar largësinë dhe për shkak të shpejtësisë



e lagështisë në rrugë ka goditur makinën tip "Range Rover", e drejtuar nga një femër që udhëtonte para tij dhe uli shpejtësinë, e më pas makinën e 4-t në radhë të eskortës ("Toyota"), e cila ka dalë nga rruga dhe ka rënë në kanal. I dëmtuar më lehtë është dhe mjeti tip "Mitsubishi", që ishte pjesë e eskortës. Nga përplasje e mjeteve janë plagosur gardistët Klodian Llaka, Erion Musai dhe Shkëlqim Pojana, të cilët sipas bluve, pas marrjes së ndihmës mjekësore ndodhen jashtë rrezikut për jetën.

GARDISTËT

Rreth 2 orë pas aksidentit në Korçë, njëri nga tre gardistët që shoqëronte eskortën e kryeministrit Rama është dërguar drejt Tiranës. Bëhet fjalë për Ervin Musain, i cili sipas

mjekëve ka pësuar dëmtime në shtyllën kurrizore. Sipas policisë, dy gardistët e tjerë ndodhen në spitalin e Korçës. Mbrëmë në media u bë me dije se dy nga gardistët e plagosur në aksident do të nisen për kurim në Turqi, pasi ndodhen në gjendje kritike për jetën. Ndërkohë, burime zyrtare nga mjekët e kryeqytetit deklaruan se momentalisht nuk kanë vendosur nisjen drejt Turqisë së gardistëve të plagosur. "Njëri nga të plagosurit, Ervin Musai ndodhet nën kujdesin intensiv të mjekëve, pasi ka probleme me shtyllën kurrizore. Ai nuk ndodhet në reanimacion, por do të shikohet në orët në vazhdim se si do të jetë ecuria e gjendjes së tij shëndetësore", thanë burime zyrtare nga Spitali i Traumës në Tiranë.

SHKURT

Përplas këmbësorin, ikën nga vendngjarja

TEPELENË - Një aksident me pasojë një të plagosur ka ndodhur mbrëmë në aksin rrugor Krahës-Tepelenë. Një automjet ka plagosur një 64-vjeçar me inicialët D.D. dhe është larguar nga vendngjarja. I plagosuri është transportuar në spitalin e Gjirokastrës dhe mësohet se ndodhet në gjendje të rëndë. "Rreth orës 18:45, në aksin rrugor Krahës-Tepelenë, një automjet ka goditur shtetasin D.D., rreth 64 vjeç, banues në fshatin Krahës, Memaliaj dhe është larguar nga vendi i ngjarjes. Shtetasi i aksidentuar u transportua për në Spitalin Rajonal Gjirokastrë dhe ndodhet në gjendje të rëndë shëndetësore. Në vendngjarje kanë shkuar shërbimet e policisë dhe po punohet për identifikimin dhe kapjen e drejtuesit të automjetit", thuhet në njoftimin e policisë.

Grabit supermarketin, në kërkim agresori

VLORË - Mbrëmjen e së dielës është grabitur një supermarket në lagjen "Hajro Çakërri" të qytetit të Vlorës. Një person i maskuar nën kërcënimin e thikës ka marrë arken me paratë që kishte brenda dhe më pas është larguar me shpejtësi. Pas sinjalizimit për grabitjen, policia ka shoqëruar disa persona, ndërsa vijojnë hetimet bazuar edhe te kamerat e sigurisë së supermarketit për të identifikuar dhe arrestuar autorin e ngjarjes.

Ngjarja me autor 20-vjeçarin ndodhi para 6 muajsh

Plagosi ushtarakun në Vaun e Dejës, përfundon në pranga i riu Pashk Gjoni

SHKODËR - Policia e Shkodrës ka mundur të zbardhë plagosjen e një ushtaraku në maj të këtij viti në Vaun e Dejës, ndërsa ka vënë në pranga autorin e kësaj ngjarjeje. Bëhet fjalë për 20-vjeçarin Pashk Gjoni, banues në Vaun e Dejës, i cili ishte shpallur në kërkim. I riu akuzohet se në datën 20.05.2017 ka plagosur me armë zjarri 23-vjeçarin E.Z., rreth 23 vjeç, me detyrë ushtarak pranë repartit ushtarak në Vau i Dejës. Sipas bluve të qytetit verior, kjo ngjarje është dokumentuar. "Më datë 26.11.2017, nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër u ndalua shtetasi në kërkim



20- vjeçari i arrestuar, Pashk Gjoni

Pashk Gjoni, 20 vjeç, banues në Vau i Dejës. Ndalimi i tij u bë pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendim nr.803, datë 20.09.2017, ka caktuar masën e sigurisë 'Arrest në burg', i dyshuar për veprën penale 'Vrasja me dashje e mbetur në tentativë' dhe 'Prodhim dhe mbajtje pa leje të armeve luftarake dhe municioneve'. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprimet të mëtejshme, thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Ra nga kati i tretë i banesës, 4-vjeçarja rëndë në spital

DURRËS - Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mesditën e djeshme në qytetin e Durrësit. Burime nga policia lokale bënë me dije se një fëmijë ka rënë nga kati i tretë i shtëpisë. Ngjarja ka ndodhur në lagjen nr. 13 ose të njohur ndryshe si Plazhi. Mësohet se 4-vjeçarja me inicialet E.M. është dërguar menjëherë nga familjarët në spitalin e qytetit bregdetar, ku dhe ndodhet në gjendje të rëndë. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, dyshohet se ngjarja është aksidentale dhe se e mitura ka rënë nga dritarja e katit të tretë të banesës. Gjithsesi, policia po heton për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

PASURINË NR. 2/963-ND-1-43 , E LLOJIT 'APARTAMENT' , VOLUMI 55 , FAQJE 73, ZONA KADASTRALE 8513 , ME SIPËRFAQE 67.81 M2 , NË ADRESËN : RRUGA "K. KËRTUSHA" , SHKALLA 1 , KATI 7 , DURRËS , NË PRONËSI TË SHTETASVE : Z. LUTFI GJYZELI DHE ZNJ. ENKELEJDA GJYZELI

ÇMIMI 4.000.000 LEKË " , Data e zhvillimit të ankandit do jetë 05.12.2017 .

ZYRA PERMBARIMORE GJYQËSORE PRIVATE 'ILIA ELEZI' Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Pallati "GORA", Kulla 1, Kati 2, Tiranë. Cel:0684026666 ; 0693262866



Automjeti tip "Jeep" ku shpërtheu eksploziv



Policia: Automjeti tip "Jeep" shpërtheu në lëvizje, i riu person me precedentë të theksuar kriminalë

Eksplziv makinës në Vlorë, gjymtohet djali i biznesmenit

Atentati me C4, 25-vjeçari Ines Hajrulla: Më çoni në spital

VLORE

Tronditet Vlorë. Një 25-vjeçar ka mbetur i plagosur rëndë në një atentat me eksploziv në makinën e tij. Mësohet se automjeti tip "Jeep" me targa AA 298 CL ishte në lëvizje, kur ka shpërthyer lënda plasëse dhe për pasojë është plagosur drejtuesi i mjetit, Ines Hajrulla, djali i një biznesmeni në qytetin bregdetar (pronar i një lokali të njohur). Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së këtij qarquri bënë me dije se ngjarja ndodhi paraditen e djeshme në lagjen "Hajro Çakërrri" të këtij qyteti tek vendi i quajtur "Bishti i Kalldrëmit". Menjëherë pas shpërthimit të fortë që tronditi banorët e zonës, forca të shumta policie kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimit. Ndërkohë, i riu (i arrestuar në vitin 2013 për grabitjen e një kazinoje) është dërguar urgjentisht në spitalin rajonal të Vlorës, ku i është dhënë ndihma e parë mjekësore. Sipas mjekëve të këtij spitali, 25-vjeçari Hajrulla ka pësuar plagë të rënda. Për shkak të dëmtimeve të shumta, i riu ka humbur (i është prerë) njërin këmbë. Më pas ai është dërguar për ndihmë në të specializuar në Tiranë, ku fatmirësisht ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Pas kryerjes së hetimeve paraprake, burime pranë grupit hetimor po huan se bëhet fjalë për një atentat të mirëfilltë, i telekomanduar. Ndërsa, dyshohet që shënjestër e atentatit të ketë qenë djali i biznesmenit. Sipas bluve, Ines Hajrulla është person me precedentë të theksuar kriminalë.

SHPËRTHIMI ME EKSPLOZIV

Sipas burimeve policore, makina tip "Jeep" ishte duke lëvizur nga prefektura në



25-vjeçari i plagosur Ines Hajrulla



GRABITJA

Burime nga policia e Vlorës dhe deklaruar se Ines Hajrulla është person me precedentë të theksuar kriminalë. Në vitin 2013 ai u arrestua, pasi dyshohej si autor i grabitjes me armë të një kazinoje në këtë qytet. Më pas i riu u la i lirë për mungesë provash. Pikërisht, përfshirja e tij në aktivitete të paligjshme është pista kryesore në të cilën po heton policia e Vlorës për atentatin me eksploziv që ndodhi paraditen e djeshme.

Tritoli në Vlorë, Berisha: Nuk jemi në Kandahar, por në Vlorën e deputetit Rama

TIRANË - Ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, ka reaguar pas atentatit me tritol që iu bë 25-vjeçarit në Vlorë. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", Berisha shkruan se kjo është Shqipëria dhe qyteti ku Rama është deputet, më keq se Kandahari.

"Nuk jemi në Kandahar, por në Vlorën e deputetit Edvin Kristaq Rama, Noriegës, qyte-



Ish-kryeministri Sali Berisha

ti ku çdo ditë bëhet nga një atentat dhe hidhen në erë njëra pas tjetrës

makinat nga mafia", - ka shkruar ish-kryeministri Berisha.

drejtim të zonës së njohur si "Bishti i Kalldrëmit". Në një distancë 80 m, automjeti ka shpërthyer dhe për pasojë është plagosur Ines Hajrulla. Nga shpërthimi i fortë, një "Fiat" i bardhë është spostuar për 2 m. Në videon e siguruar nga "News 24", vihet re 25-vjeçari i shtrirë në krah të makinës së tij, teksa kërkon

ndihmë. "O vllai hajde ndonjëri, më çoni në spital", ka thënë i riu. Ndërsa, qytetarët i janë përgjigjur: "Ja, ja, tani do vijë ambulanca". Sakaq, dëshmitarë okularë në vendin e ngjarjes thanë për "Gazeta Shqiptare" se i riu i kishte këmbët pothuajse të gjymtuara. "Kur e norxën nga makina, këmbët pothuajse

nuk i dukeshin, ishin bërë copa-copa", u shprehën ata. Pas sinjalizimit për shpërthimin, blutë kanë mbërritur në vendngjarje, ndërsa i plagosuri është dërguar në spital. Në një deklaratë për shtyp, policia ka dhënë detaje në lidhje me këtë ngjarje. "Më datë 27.11.2017, Salla Operative Vlorë është njof-

PROCEDIMI

Ines Hajrulla, i cili paraditen e djeshme u bë objekt i sulmit me tritol, aktualisht mban statusin e të pandehurit, pasi Prokuroria e Vlorës e kishte proceduar për dy akuzat, atë të "Mbajtjes së armës së zjarrit në mjedise publike" dhe "Mosbindje ndaj urdhrat të punonjësit të rendit publik". Pavarësisht kësaj, 25-vjeçari lëvizte i lirë.

tuar se në lagjen 'Hajro Çakërrri', tek 'Bishti i Kalldrëmit' ka shpërthyer një automjet në lëvizje. Shërbimet e policisë kanë shkuar në vendngjarje, ku nga verifikimet paraprake rezultoi se mjeti tip 'Jeep' me targa AA 298 CL, me drejtues shtetasin I.H., 25 vjeç, ka shpërthyer gjatë lëvizjes. Si pasojë e shpërthimit është dëmtuar dhe ndodhet në gjendje të rëndë për jetën drejtuesi i mjetit, i cili është transportuar menjëherë në Spitalin Rajonal Vlorë për të marrë ndihmë mjekësore. Dyshohet se mjeti i është vendosur lëndë eksplozive. Shtetasi I.H. është shtetas me precedentë të theksuar kriminalë. Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes", thuhet

në njoftimin e policisë lokale.

HETIMET

Sipas hetuesve të çështjes, dyshohet se automjeti tip "Jeep" me targa AA 298 CL i janë vendosur 300-400 gr tritol në pjesën e përparme në të majtë (krahu i shoferit) ku edhe ka dëmtimet më të mëdha. Për zbardhjen e detajeve dhe motivit të ngjarjes, policia dhe prokuroria e qytetit bregdetar po punojnë në disa pista. Kjo dhe për faktin se i riu është person me precedent kriminalë. Grupi hetimor po kryen verifikime për telefonatat e fundit të 25-vjeçarit. Sakaq, mësohet se Ines Hajrulla ishte me statusin e të pandehurit për dy akuzat, atë të armëmbajtjes pa leje dhe kundërshtim të forcave të policisë, por lëvizte i lirë.

KONFERENCA SHKENCORE

Është mbajtur dhe në Akademinë e Shkencave konferenca "Rrugëtimi i Shtetit të Pavarur Shqiptar nga krijimi drejt integritimit evropian". Konferenca shkencore u mbajt në kuadër të 105-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, nga Akademia e Studimeve Albanologjike.

Para mediave, prof. Beqir Meta, drejtor i Institutit të Historisë tha mbi identitetin politik të shqiptarëve pas Shpalljes së Pavarësisë se gjatë dhjetëvjetëshit të parë kur vjen puna për t'u përballur nuk e kanë pasur përgatitjen e duhur dhe kanë shfaqur dobësi. "Populli ishte i papërgatitur mirë nga ana kulturore, politike për të ndërtuar shtetin, edhe pse dëshironet në pjesën më të madhe autonominë edhe pavarësinë nga Perandoria Osmane. Ndërtimi i shtetit, bazohet mbi një substancë njerëzore jashtëzakonisht solide, me marrëdhënie ekonomike, politike edhe institucionale të forta, të cilat e kanë validitetin për të përballur shtetin", tha Meta.

Krahasuar me atë kohë, prof. Meta tha se në vitin 1990 shqiptarët ishin të papërgatitur, por jo për të ndërtuar shtetin, por për të ndërtuar një shtet që funksionon mbi institucione demokratike. "Nuk ishte i përgatitur, nuk kishte eksperiencë, nuk kishin traditë, sepse periudha e komunizmit e kishte errësuar vetëdijen edhe ndërgjegjen. Duhet që ta kapërcenin këtë, gurin e Sizifit do ta ngrinin me vështirësi dhe do të përgjuneshin, do të ngriheshin sërish etj".

Duke renditur problemet, që janë të ngjashme me ato të 100 viteve më parë, Meta vërejt se kemi probleme madhore të institucioneve, që nga qeverisja, parlamenti, parlamentarizmi pa traditë. Shtoi se parlamenti në periudhën e Zogut ka qenë më i fuqishëm, por ishte mësuar pa opozitë, pa zgjedhje të lira edhe të hapura, ndërsa në kohën e komunizmit ka qenë fiktiv, një grup politik që ndiqte vijën e partisë. Tashmë futemi te institucioni i zgjedhjeve, zgjedhje që blihen dhe manipulohen etj.

"AKADEMIA E SHKENCAVE, BEJLERËT E MËDHENJ DHE BUJQIT E GJORË"

FATMIRA NIKOLLI

Nëse flasim për institucione të konsoliduara shtetesh të mëdha, ndërsa jemi në strehën e Akademisë së Shkencave, nuk mund të anashkalosh gjendjen në të cilën kjo e fundit është. Mes kërcënimeve për shkrimje e thirrjes për rithemelim, me një asamble të shpërndarë e fonde të vëna në pikëpyetje, i paqartë mbetet edhe fati i saj. E pyes prof. Beqir Metën për të. As Akademia e Shkencave nuk i shpëton fatit të Shqipërisë sipas tij. "Institucionet tona nuk dalin jashtë shoqërisë shqiptare. E patën edhe këto shumë të vështirë të përshtatshin me demokracinë. Si rezultat i reformave është prishur Akademia, i janë hequr institutet dhe është krijuar një Akademi me asamble. Lufta është që kjo asamble të jetë efektive për shtetin dhe për zhvillimin. Kjo është kriza identitare që ne duhet të gjejmë vetveten. Ikja e institutëve duket se la boshllëk. Akademia mund ta bëjë se ka elitën e shkencëtarëve nga të gjitha fushat, të marrin projekte e studime që t'i japin rekomandime shtetit për zhvillime të degëve të ekonomisë a shoqërisë, mund të bëjnë projekte se kanë shkencëtarë që mund të drejtojnë institute e ekipe", thotë ai. Vëren se ka pasur prej tyre që e kanë konceptuar reformimin kthim të e kaluara. "Reformimi nuk është kthimi pas, është ecja para". Sipas tij, "Edhe nëse vijmë institutet prapë, asambleja e akademisë do jetë e pavarur, nuk mund të jetë mbi institutet. Nuk mundet që disa bejlerë të qëndrojnë mbi shpatullat e bujqve të gjorë që

Pavarësia

Historianët ndryshojnë qëndrim, Beqir Meta: Esat Toptani mbrojti Shkodrën

Konferencë shkencore për 105-vjetorin: Nuk ishin gati për pavarësi, por ata që kërkuan Perandorinë Osmane nuk ishin antikombëtarë

"Gjermanët u nisën të ikin në datë 28, partizanët hynë në datë 29 në Shkodër"



Në foto: Prof. Beqir Meta, drejtor i Institutit të Historisë

"DUAM BABËN"

Është kaq e njohur shprehja. Përtej ironisë, nevoja për babanë, kompleksi i Tele-

makut, është i njohur edhe në filozofi. Ne, nuk e vrasim dot babanë, ne e kërkojmë. Në një qasje paralele, prof. Meta kujton se "Kur nisi kryengritja në Shqipëri dhe Mesme, kishte shumë elementë pro-osmanë ende, osmanizmi nuk ishte larguar nga Shqipëria dhe aq më tepër kur panë kiamete të mëdha, që kombi shqiptar u copëtua në mes, që ushtritë ballkanike masakruan me mijëra shqiptarë. Kjo bëri që t'i ktheheshim idesë, që më mirë ishim me Perandorinë osmane, sepse ishim më të fortë edhe më të mbrojtur. Kjo ka disa arsye, jo se ata kanë qenë antikombëtarë. Por është një ndërgjegje e paplotësuar kombëtare, e cila në përballje me vështirësi të mëdha, kthehet mbrapa". Për të, kjo ka qenë një lloj lëvizje dëshpëruese e këtyre elementëve që dëmtoi shtetin kombëtar, duke i shtuar edhe shumë telashe.

Po kështu lëvizja vorio-epirote e mbështetur te Greqia, por që bazohej tek elemente ortodokse edhe shqiptare, te skepticizmi që kishin për ndërtimin e një shteti kombëtar.

ANËTARËSIMI NË BE

Për Metën, anëtarësimi në BE nuk është një qëllim për të marrë një patentë e për ta tundur, as që fitojmë para e asgjë. Synimi ynë kryesor është që ne të ndërtojmë shtetin tonë, institucionet tona, që të jenë të konkurrueshme me BE-në, të arrijnë njëfarë niveli, që të prodhojnë vlera për shoqërinë e për shtetin. Për profesorin, BE-në duhet ta shohim si një pikë arrijteje. Anëtarësimi sa më i shpejtë në BE, ndoshta edhe pa i arritur këto parametra do të ishte me vlerë vetëm në një pikë, me një motiv: që duke u futur brenda këtyre institucioneve të kishit një presion më të madh që institucionet e paarrira e të paplotësuar shqiptare të demokracisë (e kur them institucione jo vetëm politike, por edhe sociale, e kulturore, arsimore, kulturore) dhe vetë ndërgjegjja shqiptare që është një institucion më vete, të arrinte të bënte hapa sa me shpejt, që të shërbente si një magnet, si një forcë shtërguese, detyruese, që shqiptarët të bënin një progres sa më të shpejtë.

RISHKRIMI I HISTORISË

I sheh historianët me ndërgjegje më të qartë. Është proces, e nuk është punë e lehtë. "Është çështje reflektimi në gjithë atë mori ngjarshesh, faktesh e fenomenesh që ka ndjekur historia e shoqëria shqiptare", thotë ai. "Kumtesat e sotme iu referoheshin burimeve britanike e diplomatët britanikë a Foreign Office e kanë parë procesin e shtetformimit si një proces elementesh. Ata kanë bërë ato kritika të ashpra për procesin e shtetformimit në vitet 1920-1924, sepse kanë parë diferencat që

kishte elita politike shqiptare. Duke i studiuar në këto, mund të nxjerrim konkluzione e ky është qëllimi i historisë", tha ai, duke shtuar se analiza e "Analiza e tyre na ka ndihmuar edhe ne, për t'u rritur e formuar si historianë sepse e kemi pasur kontaktin me këto burime shumë të kufizuara, dhe fokusin e analizës sonë e kemi pasur shumë të shtrembëruar, sepse shtrembëronin konceptet tona ideologjike të së kaluarës". 100 vite më pas, e pikat e përbashkëta me shqiptarët e 1912-ës a 1920-ës janë disa. "Po, keni të drejtë. Janë të huajt që na vënë në shina, dhe kjo nuk është çështje nihilizmi, nënshtrimi apo inferioriteti. Kombet e përparuara që kanë ndërtuar institucione të fuqishme, demokratike, kanë bërë histori. Është fat që na gjenden pranë. Çështja është që t'i dëgjojmë".

ESAT TOPTANI E DATA 28

Meta pranon se një pjesë e madhe e tezave të tij kanë gjetur vend në kurrikulat shkollore. Duke kujtuar një debat të kahershëm e pyes mbi figurën e Esat Toptanit. "Është një figurë që ka dritëhijet e veta. Ka një kontribut për mbrojtjen e Shkodrës që është e vërtetuar". E pyes, sërish, "Pra, nuk e ka shiur Shkodrën"? "Sigurisht që Esati ka qenë mbrojtës i Shkodrës. Ai ka bërë një marrëveshje me malazezët, në rrethana shumë të vështira, kur nuk kishte ushqime e municione e të tjera, dhe pas një vendimi të Fuqive të Mëdha që Shkodra i përkiste Shqipërisë", thotë Meta. Shton se ka mendime të ndryshme edhe në Francë e Angli për personalitetet të ndryshme. "I njihen këto Esatit siç i njihen marrëveshjet të hapëta e të fshehta me serbët e me grekët, që t'i jepnin atij mbështetje e suport për t'u bërë sundimtar i Shqipërisë për të realizuar objektivat e veta".

A janë të qarta tanimë historianët, nëse Shqipëria u çlirua më 28 apo më 29 nëntor? Meta qesh. "Të gjithë historianët janë në një mendje që gjermanët janë larguar nga Shkodra, nga qyteti i Shkodrës, mbrëmjen e datës 28 nëntor, duke gdhirë 29-a. Janë larguar gjatë kësaj nate. Dhe me siguri ka zgjatur edhe pas orës 12:00 se nuk kishte si lëviznin para orës 12, se një ushtri ka shumë organizime konvencionale e nuk mund të largoheshin brenda disa orësh të mbrëmjes. Janë larguar në këtë mbrëmje. Nëse ata kanë ikur mes dy datave nuk është faji i historianëve. Dhe partizanët kanë hyrë në datën 29 në mëngjes. Nga ana tjetër, partizanët hynë në Shkodër pa luftë, e kishin rrethuar Shkodrën, por nuk po luftonin me gjermanët".



Në foto: Esat Pasha në Paris, 1920

Takimi kombëtar me studentët në prag të festave të 28-29 Nëntorit, konferencë mbi lidershipin

"Luarasi", leksion për marrëveshjen e deficit

Analisti Agron Alibali: Një palë e tretë të zgjidhë çështjen

Në ambientet e Kolegjit Universitar "Luarasi" është mbajtur një leksion i hapur për paktin detar me Greqinë, nga analisti shqiptaro-amerikan i çështjeve ballkanike, Agron Alibali. E vërteta e paktit detar me Greqinë doli në dritë pas një alarmi të lëshuar nga gazetarët e "Gazeta Shqiptare", të cilët investiguan dhe zbuluan në kohë rekord përmbajtjen e tij dhe e bënë publike menjëherë të nesërmen e nënshkrimit të marrëveshjes, më 28 prill 2009. Përmes kësaj marrëveshjeje, Greqia i rrëmbente Shqipërisë rreth 300 km katrorë det. Por, denoncimi në media, reagimi i opozitës e publikut dhe në fund vendimi i Gjykatës Kushtetuese e hodhi poshtë marrëveshjen si të papajteshme me Kushtetutën në vitin 2010. Sot, pakti detar mes Greqisë dhe Shqipërisë mbetet një çështje e hapur për palën greke, ndërsa për atë shqiptare, vendimi është marrë e marrëveshja nuk ekziston. Në leksionin e hapur, analisti Alibali u tha studentëve se nëse pala greke ngul këmbë në parametrat e mëparshëm, të hedhura poshtë nga Gjykata Kushtetuese, atëherë çështja duhet të zgjidhet nga një palë e tretë ndërkombëtare. "Pala greke, ashtu edhe ajo shqiptare janë para një shansi historik që të krijohet një zgjidhje e problemeve të akumuluar



Analisti Agron Alibali në leksionin e hapur në ambientet e "Luarasi"

Nëse pala shqiptare dhe ajo greke nuk arrijnë në një marrëveshje të re, atëherë çështja duhet të zgjidhet në Gjykatën e Arbitrazhit në Hagë"

prej vitesh, kryesisht prej qasjeve nacionaliste nga pala greke. Negociatat besoj



kanë qenë të një besimi të mirë. Vetë fakti që po bisedohet është shumë pozitiv.

Kotzias dhe Bushati janë të dy diplomatë me përvojë dhe vizionarë", - u shpreh anal-

"Pala greke, ashtu edhe ajo shqiptare janë para një shansi historik që të krijohet një zgjidhje e problemeve të akumuluar prej vitesh, kryesisht prej qasjeve nacionaliste nga pala greke. Negociatat besoj kanë qenë të një besimi të mirë. Vetë fakti që po bisedohet është shumë pozitiv. Kotzias dhe Bushati janë të dy diplomatë me përvojë dhe vizionarë"

isti. Më tej, ai theksoi se ligji i gjendjes së luftës duhet hequr nga tryeza, pasi e ka vlerësuar si një relikë të historisë, që është në dëm të palës shqiptare nga ana civile. "Palët kanë tagrin që të lidhin marrëveshjet mbi bazën e kushteve që zgjedhin. Pra, vullneti i palëve është parësor, thelbësor. Kur palët nuk arrijnë të bien dakord, atëherë duhet një palë e tretë. Konventa apo Kushtetuta e deficit përcakton tri forume: Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, tribunalin e Hagës dhe Gjykatën e së Drejtës në Hamburg. Nëse pala shqiptare dhe ajo greke nuk arrijnë në një marrëveshje të re, atëherë

çështja duhet të zgjidhet në Gjykatën e Arbitrazhit në Hagë", - shtoi në faljen e tij Alibali. Më tej, ai tha se ishte pala greke, ajo që ushtroi trysin ndaj palës shqiptare e kjo solli që pozitat të mos ishin të barabarta e me vullnet të lirë, por të disfavorshme. Në Kolegjin Universitar "Luarasi" u zhvillua jo vetëm një takim shkencor, por edhe kombëtar në prag të festave të 28-29 nëntorit me pjesëmarrjen edhe të studentëve të universitetit "Haxhi Zeka", Pejë. Gjithashtu, studentët kanë organizuar edhe një konferencë lidhur me çështjet e menaxhimit të strukturave rinore dhe lidershipit.

Denoncimi: Të njëjtat mjete lëvizin në qendër të Tiranës

U sekuestruan në shtator, makinat luksoze i kthehen pronarit

Operacionet policore "Forca e Ligjit" dhe "Vjeshtë 2017" kanë qenë të suksesshëm vetëm në statistika, pasi realitetit tregon të kundërtën. Duket se operacionet policore "Forca e Ligjit" dhe "Vjeshtë 2017" të lançuara me pompozitet nga Ministria e Brendshme kanë qenë të suksesshme vetëm në statistikat e policisë, pasi në realitet nuk kanë rezultuar të tilla. "ABC News" ka rritur të sigurojë një video kundër asaj të policisë, e cila njoftonte në

AUTOMJETET

Në muajin shtator policia e Tiranës njofton për sekuestrimin e 4 automjete të blinduara në Tiranës, ku dyshohej se në të qarkullonin elemente kriminale. Por hetimet u nisën e u mbyllën nga prokuroria e kryeqytetit, duke i kthyer automjetet e blinduara pronarit të tyre.

muajin shtator se kishte arritur të sekuestronte 4 automjete të blinduara në Tiranës, ku dyshohej se në të qarkullonin elemente kriminale. Por, hetimet u nisën e u mbyllën nga prokuroria e

kryeqytetit, duke i kthyer automjetet e blinduara pronarit të tyre. Ky është moment kur makinat dalin nga pikat e bllokimit në zonën e Arbanës. Më pas, siç shikohej edhe nga pamjet, të

njëjtat automjete lëvizin si eskortë edhe në qendër të Tiranës. Ky nuk është rasti i parë që operacionet policore më tepër zhvillohen për të kapur ekranet televizive se sa për të goditur krimin organizuar, siç është edhe qëllimi i ngritjes së tyre. E njëjta gjë ka ndodhur edhe dy aksonet "Forca e Ligjit" të zhvilluar në Fier e Shkodër. Fillimisht u kap një person me 100 gramë



Makina e sekuestruar

kanabis dhe gjatë kontrollit në automjet u gjet edhe një armë zjarri. Ndërsa në Shkodër u prangos një i dyshuar

tutor prostitutash, pasi në hotelin e tij u gjet një ambient i përshtatshëm për aktivitet kriminal.

MINISTRIA E DREJTËSISË DREJTORIA E PERGJITHSHMË E PERMBARIMIT ZYRA PERMBARIMORË TIRANË

Zyra e Permbarimit Tirane, me permbarues gjyqësor Albert Fejzo, në baze të vendimit nr. 10019, datë 16.11.2017, shpall shpëtim në ankand të pasurisë apartamentit të banimit me sipërfaqe 57m2, të ndodhur në Rrugën: "Irfan Tomini", pallati 10/2/60 në Zonën kadastrale 8260 të regjistruar Zyra Vendore Regjistrimit Pasurisë Palujshme Tirane me nr pasurie nr.294+4-60, volume 6, faqe 82 Tirane, në vlerën 2.800.000 (dy milion e tetëqind mijë) Lekë. Ankandi zhvillohet në ambientet e Zyres të Permbarimit Tirane, në adresën: "Sheshi Mustafa Ataturk, kryeqendri" 21 dhjetori, Tirane ditën e Premte, me datë 08.11.2017, ora 16.00.

PERMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin për shitjen e pasurisë së palujshme "Fyli me sipërfaqe totale 551 m², me Nr.Pasurie 629/6, Volumi 9, Faqe 157, Zona Kadastrale 2460, e ndodhur në Linzë, Tiranë", e lenë kolaterale për garantimin e kredisë, për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorit ProCredit Bank Sh.a., për shumën 1'202'701.28 (një milion e dyqind e dy mijë e shtatëqind e një qindë mijë e tetëqindë lekë). Ankandi zhvillohet në datën 05.12.2017, ora 16.00 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, rruga Abdull Topani, qendra Torre Drin, kl.2,nr.33,Tirane, dhe për informacion mund të kontakton në nr.0682099471,0695370060, email ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.

PERMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e dytë për shitjen e pasurisë së palujshme "Apartamenti", me Nr.Pasurie 5330+1-8, Zona Kadastrale 8513, Vot14, Fq.69, me sipërfaqe 52.02 m², të ndodhur në P.Sorra/17, Pall.97B/1, Shk.1, Ap.8, Durres, e lenë kolaterale për garantimin e kredisë, për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorit ProCredit Bank Sh.a., për shumën 1'961'130.58(një milion e nëntëqind e gjashtëqindë e një mijë e njëqind e tridhjetë qindë pesëqindë e tetëqindë lekë dhe 33 dhjetorë e tre qindë gjashtëqindë Euro. Ankandi zhvillohet në datën 05.12.2017, ora 16.00 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, rruga Abdull Topani, qendra Torre Drin, kl.2,nr.33 Tirane, dhe për informacion mund të kontakton në nr.0682099471,0695370060, email ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.

Gjyqtari 46-vjeçar, prej 4 ditësh në gjendje të rëndë shëndetësore

Avokati kërkoi lirim, Apeli në burg gjyqtarin Shkëlqim Miri

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda vendosi të lërë në burg gjyqtarin Shkëlqim Miri, i dyshuar për akuzën e korrupsionit. Gjykatësi Miri prej katër ditësh është transferuar në spitalin e burgut, në gjendje të rënduar shëndetësore. Pavarësisht kërkesës së avokatit mbrojtës për lehtësim të masës së sigurisë për shkak të gjendjes shëndetësore të klientit të tij, kjo kërkesë nuk u mor për bazë nga apeli. Gjatë seancës gjyqësore Shkëlqim Miri nuk ka mundur të jetë prezent për shkak të problemeve shëndetësore. Avokati Ardian Visha këmbënguli në shkallën e dytë të gjyqësorit që klientit të tij t'i jepet masa e sigurisë "arrest shtëpie", pasi sipas tij, nuk ekziston rreziku që Miri të largohet, të prishë provat apo të kryejë veprën penale. Visha ka theksuar se 46-vjeçari Miri prej muajsh është diagnostikuar me tumor, avokati tha se gjyqtari Miri duhet të lirohet nga qelia. Sakaq, trupa gjyqësore e kryesuar nga Gjovalin Përnoça vendosi të lërë masën "arrest me burg" për Shkëlqim Mirin.

NGJARJA

46-vjeçari Shkëlqim Miri u ndalua në kuadër të operacionit policor "Një vrasje e dytë". Ai akuzohet për veprën penale të korrupsionit të funksionarëve të drejtësisë. Gjyqtari i Apelit të Tiranës dyshohet se favorizoi të dënuarin Gentian Doda, duke i ndryshuar akuzën nga vrasje me paramendim, në plagosje të rëndë me pasojë vdekjen kundrejt një shume të konsideruar parash. Prokuroria për Krime të Rënda thotë se ka prova të mjaftueshme që e implikojnë gjykatësin në skemën korruptive.

Në burg ndodhet edhe kushëriri i tij, Kujtim Miri, i cili dyshohet se ka pasur rolin e sekserit dhe se në një lokal në Fushë Krujë ka marrë zarfën me para nga Alban Buci, miku i ngushtë i Gentian Dodës. Prokuroria thekson se paratë janë marrë në emër dhe për llogari të gjykatësit, në shtëpinë e të cilit u gjetën 340 milionë lekë.

Por, ndërsa gjykatësi dhe kushëriri i tij janë vënë në pranga dhe ndaj tyre ka nisur edhe hetimi pasuror, kërkimet e policisë për të arrestuar Gentian Doda dhe Alban Bucin nuk kanë dhënë rezultat.

Sakaq, më herët avokati mbrojtës i Shkëlqim Miri, Ardian Visha ka thënë se në muajin maj gjyqtari është ekzaminuar me tumor në kokë në Gjermani. Ai ka dhënë shpjegime rreth shumës së parave të gjetur në shtëpinë e gjyqtarit. "Shuma është relative në kushtet ku jetojmë. Ky gjyqtar ka 25 vite që punon me një rrogë të konsiderueshme. Edhe bashkëshortja me rrogë të konsiderueshme. Ka problematikë shëndetësore. Në fund të majit është ekzaminuar në Gjermani me tumor në kokë. Një pjesë e parave ishin të tija, ndërsa të tjerat ishin pjesë e një marrëveshje kontraktuale me një familjar. Paratë do të përdorehin për kurimin e tij. Ka mungesë relacioni logjik nga prokuroria, ka një dinamikë prej janarit deri në fund të majit, pastaj ka një boshllëk nga karakteri hetimor, më pas prokuroria i kërkon gjykatës për të bërë kontroll në banesë. Natyrisht, shfrytëzimi i bumit mediatic e ka bërë efektin, që u përdor nga prokurori për të kërkuar masën ekstreme. Detyrë e prokurorisë është të provojë natyrën kriminale të parave të gjetura. Kjo gjë nuk u bë, as në akte, as nuk u provua. Po të kishte prova, do ishte arrestuar para kontrollit të banesë. Ka qenë 3 herë në kontakt me policinë atë ditë, nëse do kishte rrezik, do ishte larguar", është shprehur avokati mbrojtës i Shkëlqim Miri, Ardian Visha.

GJYQTARI SHKËLQIM MIRI

Pas ndalimit nga blutë e kryeqytetit me urdhër të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, "GSH" ka mundur të zbardhë dëshminë e gjyqtarit Shkëlqim Miri. Gjatë marrjes në pyetje, ai ka thënë se vetëm një pjesë e parave ishin të tij (rreth 3 mln lekë), ndërsa pjesa tjetër ishte e një të afërmi të tij, i cili do të blinte një pronë në Tiranë. "Rreth 3 milionë lekë janë të miat, pjesa tjetër të një të afërmi, i cili m'i kishte lënë sepse do blinte një pronë të Tiranë. Kursimet i kisha nga pagat dhe i mbaja në shtëpi", është shprehur gjyqtari. Shkëlqim Miri është marrë në pyetje nga prokurori Klodjan Braho dhe dy oficerë të policisë gjyqësore në prani të avokatit të tij,

Ardian Visha, 46-vjeçari, i cili u ndalua nga policia për shpërdorim detyre dhe korrupsion rrezikon të dënohet deri në 4 vite burg. "Premtimi, propozimi ose dhënia drejtpërdrejtë ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë,

gjyqtarit, prokurorit ose çdo punonjësi tjetër të organeve të drejtësisë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën e funksionit e tij, dënohet me burgim nga një vit deri në katër vjet dhe me gjobë nga katërqind mijë deri në dy milionë lekë", thuhet

në nenin 319. Shkëlqim Miri ka një karrierë 25-vjeçare në drejtësi, që nga gjyqtar i Shkallës së Parë, më tej gjyqtar Apeli në Durres, anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga 2007 deri në 2011-en dhe së fundmi, gjyqtar i Apelit në Tiranë.



SHËRBIMI EKSPRES POSTAR NË SHQIPËRI DHE NË TË GJITHË BOTËN.

- * 200 destinacione në të gjithë botën
- * Gjurmim online 24 orë për çdo dërgesë Ekspres
- * Shërbime në zyrat postare në 7 ditë të javës

SHPEJT. SIGURT. KUDO.



POSTA SHQIPTARE



www.postashqiptare.al

Të gjithë kandidatët e diplomuar në mjekësi, infermieri, fizioterapi, farmaci, stomatologji, mësuesi, logopedi, mami, teknik imazherie e teknik laborator...

AKP: Profesionet e rregulluara, ja dokumentacioni që duhet të dorëzoni

Provim shtetëror për mjekët, stomatologët e infermierët

Shpallen listat me emrat e kandidatëve

studimit jashtë shtetit. Ndërkaq, personi që kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar duhet të ketë përfunduar programin përkatës të akredituar të studimit dhe/ose kualifikime profesionale në atë profesion, të cilat vërtetohen me dokumente zyrtare.

RREGULLORJA

AKP bën me dije edhe rregullat që kandidatët duhet të zbatojnë ditën e provimit. "Për paraqitjen në qendrat e provimit kandidatët duhet të ketë parasysh rregullat e mëposhtme: 1. Ndalohet marrja me vete dhe përdorimi i celularëve dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter s'kualifikimi; 2. Ndalohet dhuni, dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit; 3. Ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të provimit."

ORGANIZIMI I PROVIMEVE TË SHTETIT PËR PROFESIONET E MJEKËSISË SEZONI XIII NËNTOR DHJETOR 2017

Table with columns for dates (E hënë 20.11.2017, E martë 21.11.2017, E mërkurë 22.11.2017, E enjte 23.11.2017, E prente 24.11.2017) and professions (Infermier, Farmaci, Stomatologji, Mami, Fizioterapi).

MAMI / SEZONI XIII DHJETOR 2017

- Nr. Emër Ateshi Mbiemer Oriari
1 Adriana Irfani Boshku 13.12.2017 09:00
2 Afrida Sokol Pepkollaj (Ndrepepaj) 13.12.2017 09:00
3 Afljona Avni Dulla 13.12.2017 09:00
4 Albana Muho Allaj (Vokrr) 13.12.2017 09:00
5 Albana Robert Canaj 13.12.2017 09:00
6 Albina Skënder Doka 13.12.2017 09:00
7 Albina Oazin Zaimi 13.12.2017 09:00
8 Aldi Luan Bahidi 13.12.2017 09:00
9 Aldila Ideali Musollari 13.12.2017 09:00
10 Alkela Arben Bora 13.12.2017 09:00
11 Alina Bashkim Alushi 13.12.2017 09:00
12 Amanda Rasin Smalaj 13.12.2017 09:00
13 Amandaja Besnik Kadaja 13.12.2017 09:00
14 Amariada Abaz Pulpja 13.12.2017 09:00
15 Andronika Ramondil Koliçi 13.12.2017 09:00
16 Anisa Hekuran Samurri 13.12.2017 09:00
17 Anisa Murat Xhafari 13.12.2017 09:00
18 Antonina Bujar Mema 13.12.2017 09:00
19 Anxhela Irfan Lamçe 13.12.2017 09:00
20 Anxhela Bardhyl Shurdha 13.12.2017 09:00
21 Anxhela Dritlan Zenelli 13.12.2017 09:00
22 Anxhela Pandel Gjini (Beqiri) 13.12.2017 09:00
23 Anjeza Shaqir Luli 13.12.2017 09:00
24 Arbësa Nazmi Jashari 13.12.2017 09:00
25 Ardita Bashkim Balli (Duro) 13.12.2017 09:00
26 Ardita Adrian Bame 13.12.2017 09:00
27 Arlina Aqitj Mane 13.12.2017 09:00
28 Arjolaja Qelbi Toska 13.12.2017 09:00
29 Armanda Urim Jaçelli 13.12.2017 09:00
30 Arminada Kadri Haxhija (Sholli) 13.12.2017 09:00
31 Arsiada Can Hykaj 13.12.2017 09:00
32 Arta Bardhok Gjoka 13.12.2017 09:00
33 Artenca Xhevarhi Çola 13.12.2017 09:00
34 Bardhe Gjoke Maku 13.12.2017 09:00
35 Basri Femi Dani 13.12.2017 09:00
36 Besjana Bilal Mimini 13.12.2017 09:00
37 Blenarda Bardhyl Likaj 13.12.2017 09:00
38 Blerina Bujar Alliu 13.12.2017 09:00
39 Blerina Gurali Lumi 13.12.2017 09:00
40 Bora Sinan Hysi 13.12.2017 09:00
41 Bríkëna Astrit Memollari 13.12.2017 09:00
42 Brunilda Kujtim Albargjimi 13.12.2017 09:00
43 Brunilda Tahir Myzeqari 13.12.2017 09:00
44 Dafila Tago Leka 13.12.2017 09:00
45 Daniela Pandel Loshi 13.12.2017 09:00
46 Danjela Hekuran Brahollli 13.12.2017 09:00
47 Danjela Bujar Sala 13.12.2017 09:00
48 Deje Livan Seda 13.12.2017 09:00
49 Denisa Skender Bregasi 13.12.2017 09:00
50 Denisa Shkëqim Duda (Gjika) 13.12.2017 11:30
51 Denisa Fatmir Lendrakuhli 13.12.2017 11:30
52 Denisa Valter Tabaku 13.12.2017 11:30
53 Denjona Feim Sulfi 13.12.2017 11:30
54 Desara Kujtim Zogaj 13.12.2017 11:30
55 Djana Gjovalinj Doga 13.12.2017 11:30
56 Dorina Pal Gjoni 13.12.2017 11:30
57 Dorina Oazin Rajta (Slafa) 13.12.2017 11:30
58 Durime Jakup Rika 13.12.2017 11:30
59 Dhurata Petrit Hoxhaj 13.12.2017 11:30
60 Eliona Lulezim Mema 13.12.2017 11:30
61 Elmira Vladmir Murataj 13.12.2017 11:30

- 125 Lindita Adem Saliaj (Çela) 13.12.2017 14:00
126 Lindita Besnik Xhihenaj 13.12.2017 14:00
127 Lorena Sajmir Horalinj 13.12.2017 14:00
128 Lorena Nuri Lazaj 13.12.2017 14:00
129 Lorena Arjan Çaçaj 13.12.2017 14:00
130 Luljeta Ferdinand Bardhi 13.12.2017 14:00
131 Lunida Nikolin Troshani 13.12.2017 14:00
132 Lutifje Sade Melis 13.12.2017 14:00
133 Malbora Çelink Klezi 13.12.2017 14:00
134 Malvina Tomorri Çepeleci 13.12.2017 14:00
135 Marcela Dashmiri Shima 13.12.2017 14:00
136 Marjola Arben Manko 13.12.2017 14:00
137 Marjeta Gezim Jaupaj 13.12.2017 14:00
138 Marsela Ramazan Labolli 13.12.2017 14:00
139 Matilda Arif Zeneli (Kuka) 13.12.2017 14:00
140 Matilda Xhevarhi Hana 13.12.2017 14:00
141 Matilda Gjini Leka 13.12.2017 14:00
142 Megi Sal Çausi 13.12.2017 14:00
143 Merjeme Besnik Leshi 13.12.2017 14:00
144 Midela Agim Veseli 13.12.2017 14:00
145 Miroslava Myftar Zeqo 13.12.2017 14:00
146 Mirela Fadil Selçetaj 13.12.2017 14:00
147 Nazlyze Ismail Hoxha 13.12.2017 14:00
148 Nazajola Besnik Bekta 13.12.2017 14:00
149 Nensi Agim Lala 13.12.2017 09:00
150 Neritla Arif Zeneli (Kuka) 13.12.2017 09:00
151 Nilisa Halli Duro 14.12.2017 09:00
152 Orijana Faik Xhabrahimi 14.12.2017 09:00
153 Orjona Defrim Plaku 14.12.2017 09:00
154 Orlinda Nazmi Tagani 14.12.2017 09:00
155 Paola Anxhak Skendi 14.12.2017 09:00
156 Paula Zaim Kaja 14.12.2017 09:00
157 Pranvera Petro Karaj 14.12.2017 09:00
158 Realda Xhevat Biva 14.12.2017 09:00
159 Remjiana Edmond Kutrolli 14.12.2017 09:00
160 Renjida Ramazan Gata 14.12.2017 09:00
161 Rezarta Rexhep Gjata 14.12.2017 09:00
162 Safete Leonard Çalo 14.12.2017 09:00
163 Safije Refat Gorovelli (Çela) 14.12.2017 09:00
164 Sidorela Fatmir Kallini 14.12.2017 09:00
165 Sidorela Agim Mula 14.12.2017 09:00
166 Sildi Fatmir Sela 14.12.2017 09:00
167 Silviana Kristaj Hajmelja 14.12.2017 09:00
168 Solida Kastriot Caca (Matmaja) 14.12.2017 09:00
169 Sonia Sokol Kronaj 14.12.2017 09:00
170 Shage Abdin Borakaj 14.12.2017 09:00
171 Shefika Haxhi Malaj 14.12.2017 09:00
172 Shpresa Nikoll Hila 14.12.2017 09:00
173 Vjola Sela Ballabanaj 14.12.2017 09:00
174 Xheslida Xhevarhi Koka 14.12.2017 09:00
175 Xhona Eduart Mekkelli 14.12.2017 09:00
176 Xhujana Fatos Buzi 14.12.2017 09:00
177 Xhujeta Sami Sinaj 14.12.2017 09:00
178 Zamira Ded Marku 14.12.2017 09:00
179 Zana Fatos Çragaj 14.12.2017 09:00
180 Zoje Lush Curri 14.12.2017 09:00
181 Eggesa Luan Dodoveci 14.12.2017 09:00

- 4 Albana Qamil Xibraku 06.12.2017 09:00
5 Albi Gezim Hafizi 06.12.2017 09:00
6 Albina Behar Dragoti 06.12.2017 09:00
7 Alket Melaim Troci 06.12.2017 09:00
8 Almarina Kujtim Gjergji (Arap) 06.12.2017 09:00
9 Allin Riza Mici 06.12.2017 09:00
10 Amena Jetmir Selimi 06.12.2017 09:00
11 Anda Bujar Muçaj 06.12.2017 09:00
12 Anisa Arben Haxhijaj 06.12.2017 09:00
13 Anisa Kastriot Tafa 06.12.2017 09:00
14 Anxhelino Vladim Malaj 06.12.2017 09:00
15 Arber Pellumb Celaj 06.12.2017 09:00
16 Ardit Sadik Bajramaj 06.12.2017 09:00
17 Ardit Pjetër Kaci 06.12.2017 09:00
18 Ardit Hamza Kapxhiu 06.12.2017 09:00
19 Ardit Gjoni Marku 06.12.2017 09:00
20 Arlind Bardhyl Alushaj 06.12.2017 09:00
21 Armand Zini Xhani 06.12.2017 09:00
22 Artana Athanas Lefteri 06.12.2017 09:00
23 Artan Muharrem Doda 06.12.2017 09:00
24 Arterisa Sait Ymeri 06.12.2017 09:00
25 Arvi Arben Guri 06.12.2017 09:00
26 Arviolta Mylli Nure 06.12.2017 09:00
27 Arzu Sulejman Mamo 06.12.2017 09:00
28 Aurora Edmond Sedja 06.12.2017 09:00
29 Besjan Bashkim Qalliu 06.12.2017 09:00
30 Bledar Lazim Blirio 06.12.2017 09:00
31 Bledar Nikoll Cetina 06.12.2017 09:00
32 Bledar Man Lushio 06.12.2017 09:00
33 Blediana Hajdar Hoxha 06.12.2017 09:00
34 Borana Ylli Bilal 06.12.2017 09:00
35 Borana Servet Caushllari 06.12.2017 09:00
36 Brikena Roland Greca 06.12.2017 09:00
37 Brunilda Pjerin Loka 06.12.2017 09:00
38 Brunilda Fadil Shahinaj 06.12.2017 09:00
39 Dajland Elez Metalla 06.12.2017 11:30
40 Daniela Zef Mardoda 06.12.2017 09:00
41 Dardan Lulezim Serca 06.12.2017 09:00
42 Darovi Muhamet Basha 06.12.2017 09:00
43 Denis Sait Ymeri 06.12.2017 09:00
44 Denisa Fatmir Dami 06.12.2017 09:00
45 Denisa Ilo Mustafa 06.12.2017 11:30
46 Deton Rexhep Kerciku 06.12.2017 09:00
47 Disuzza Arben Kasula 06.12.2017 11:30
48 Donin Todi Guxo 06.12.2017 09:00
49 Dren Bujar Nushi 06.12.2017 09:00
50 Dritan Fatos Sopoli 06.12.2017 11:30
51 Edson Pellumb Guri 06.12.2017 11:30
52 Edision Asim Shimag 06.12.2017 11:30
53 Edmir Myllam Tosku 06.12.2017 11:30
54 Ejona Jani Mjeshterovaj 06.12.2017 11:30
55 Eldir Roland Katrosi 06.12.2017 11:30
56 Elena Adriatik Loka 06.12.2017 11:30
57 Elenica Ilir Thanati (Gjoni) 06.12.2017 11:30
58 Elisha Shafiq Muka 06.12.2017 11:30
59 Elisabeta Hamit Miltarja 06.12.2017 11:30
60 Elson Imer Koliqi 06.12.2017 11:30
61 Elvi Leonard Hoxha 06.12.2017 11:30
62 Emanuel Emin Kalemi 06.12.2017 11:30
63 Emiljan Ali Sado 06.12.2017 11:30
64 Eneida Musa Aslanaj 06.12.2017 11:30
65 Enfid Myzajlen Hoxha 06.12.2017 11:30
66 Enida Nezir Islami 06.12.2017 11:30
67 Enigert Naun Doko 06.12.2017 11:30
68 Enisa Shkelqim Rexhepi 06.12.2017 11:30
69 Ensi Vladimir Selhi 06.12.2017 11:30
70 Enverin Kasem Khanaj 06.12.2017 11:30
71 Erald Riza Toska 06.12.2017 11:30
72 Erges Cirilli Llambo 06.12.2017 11:30
73 Ergesjet Namik Lumbaj 06.12.2017 11:30
74 Ergys Musa Dyllio 06.12.2017 11:30
75 Erjola Abdyl Zgura 06.12.2017 11:30
76 Erjon Daut Çela 06.12.2017 11:30
77 Erjon Pelivan Hasanaj 06.12.2017 11:30
78 Erindit Petref Çalo 06.12.2017 11:30
79 Ermir Binak Bokciu 06.12.2017 11:30
80 Ermir Bukurosh Meça 06.12.2017 11:30
81 Ermir Shkelqim Shehi 06.12.2017 11:30
82 Ermina Mane Çekrozi 06.12.2017 11:30
83 Ertan Luan Kisha 06.12.2017 11:30
84 Ervin Mhill Ndreuo 06.12.2017 11:30
85 Ervin Çezim Xhafa 06.12.2017 11:30
86 Esmerina Piro Topallio 06.12.2017 11:30
87 Emir Jaho Kodaj 06.12.2017 11:30
88 Emlid Kujtim Beqaj 06.12.2017 11:30
89 Fabion Elez Basriku 06.12.2017 11:30
90 Faton Elton Xhepa 06.12.2017 11:30
91 Fajton Safet Brenolli 06.12.2017 11:30
92 Fajton Ismet Kupraj 06.12.2017 11:30
93 Fajton Agon Sadikaj 06.12.2017 11:30
94 Fajton Ibrahim Beqaj 06.12.2017 11:30
95 Filippo Francesco Procinio 06.12.2017 11:30
96 Fjona Gezim Zaranova 06.12.2017 11:30
97 Fjoralba Artur Djeteljaj 06.12.2017 11:30
98 Fjorber Shqipri Isufaj 06.12.2017 11:30
99 Flaures Ulusi Nofullajo 06.12.2017 14:00
100 Florenc Sabri Muça 06.12.2017 14:00
101 Flutura Agim Hoxha 06.12.2017 14:00
102 Francesca Gani Çela 06.12.2017 14:00
103 Frensis Harilla Mudo 06.12.2017 14:00
104 Gentjan Ismail Dudo 06.12.2017 14:00
105 Gentjana Sher Bashataj 06.12.2017 14:00
106 Gentjana Cafit Ymeri 06.12.2017 14:00
107 Gentjana Anor Yildizoglu 06.12.2017 14:00
108 Gersi Paljin Duhaj 06.12.2017 14:00
109 Grisilda Idriz Strugaj 06.12.2017 14:00
110 Hadjica Aleks Talo 06.12.2017 14:00
111 Haki Agim Bardhi 06.12.2017 14:00
112 Haki Zija Hoxha 06.12.2017 14:00
113 Haki Ruzin Rucio 06.12.2017 14:00
114 Irena Dillaver Xhina 06.12.2017 14:00
115 Ihs Riz Meksuli 06.12.2017 14:00
116 Ivana Celeste Nava 06.12.2017 14:00
117 Jera Haxhi Halimi 06.12.2017 14:00
118 Jelton Hymer Çela 06.12.2017 14:00
119 Jerron Muhamet Mela 06.12.2017 14:00
120 Jona Ibrahim Dibra 06.12.2017 14:00
121 Haki Agim Bardhi 06.12.2017 14:00
122 Juljan Ali Çika 06.12.2017 14:00
123 Kjetil Albert Loka 06.12.2017 14:00
124 Klajdi Enver Kurmia 06.12.2017 14:00
125 Kleona Besnik Xhepexhiu 06.12.2017 14:00
126 Kleonard Hysni Sulaj 06.12.2017 14:00
127 Klevis Vladimir Vautaj 06.12.2017 14:00
128 Kodjan Pjeter Kola 06.12.2017 14:00
129 Kosida Mjellaj Vera 06.12.2017 14:00

STOMATOLOGJI / SEZONI XIII DHJETOR 2017

- Nr. Emër Ateshi Mbiemer Oriari
1 Adeline Rasin Shehu (Kovaci) 06.12.2017 09:00
2 Alban Hysen Hysa 06.12.2017 09:00
3 Alban Luan Memo 06.12.2017 09:00

67 Herta Erqan Tivari 11.12.2017 11:30
 68 Ilda Dionis Hoxhaj 11.12.2017 11:30
 69 Irlir Feta Balla 11.12.2017 11:30
 70 Ina Luzim Xhiani 11.12.2017 11:30
 71 Inida Bekmeti 11.12.2017 11:30
 72 Inva Ladinir Zotaj 11.12.2017 11:30
 73 Irla Shefqet Xhemollari 11.12.2017 11:30
 74 Irlida Sulejman Dajli 11.12.2017 11:30
 75 Jerasimos Irl Berelli 11.12.2017 11:30
 76 Joana Agron Prifti 11.12.2017 11:30
 77 Jola Siman Kërpaçi 11.12.2017 11:30
 78 Jona Kasnir Baboçi 11.12.2017 11:30
 79 Jona Flamur Shkurti 11.12.2017 11:30
 80 Juliana Shkelqim Bodinaku 11.12.2017 11:30
 81 Kamele Gramos Osmani 11.12.2017 11:30
 82 Klodian Dhimtraq Gace 11.12.2017 11:30
 83 Krisit Gjoni Kola 11.12.2017 11:30
 84 Lidia Samir Zmëjani 11.12.2017 11:30
 85 Loriana Ili Logoti 11.12.2017 11:30
 86 Lysien Sejfi Mero 11.12.2017 11:30
 87 Malvina Zyber Isaku 11.12.2017 11:30
 88 Marin Niko Pecini 11.12.2017 11:30
 89 Marius Gezim Çano 11.12.2017 11:30
 90 Marlin Cemal Şuani 11.12.2017 11:30
 91 Mevlude Kujtim Kasmi 11.12.2017 11:30
 92 Mirel Jorgji Prifti 11.12.2017 11:30
 93 Mistela Stefan Çosi 11.12.2017 11:30
 94 Nehada Vehbi Gruda 11.12.2017 11:30
 95 Olivja Ferdinand Shabani 11.12.2017 11:30
 96 Osi Nasi Ristani 11.12.2017 11:30
 97 Oljtan Gari Loza 11.12.2017 11:30
 98 Oresta Asiri Avdullari 11.12.2017 11:30
 99 Orges Irljan Prifti 11.12.2017 14:00
 100 Ozim Zeqo Çli 11.12.2017 14:00
 101 Redi Adem Kapllani 11.12.2017 14:00
 102 Reshat Ramir Nela 11.12.2017 14:00
 103 Rikidian Qani Braho 11.12.2017 14:00
 104 Samir Fiqiri Çela 11.12.2017 14:00
 105 Sara Arben Kertusha 11.12.2017 14:00
 106 Sigi Flamur Hasani 11.12.2017 14:00
 107 Sumela Alifred Gjalla 11.12.2017 14:00
 108 Taner Ahmet Adkamar 11.12.2017 14:00
 109 Tea Arben Doko 11.12.2017 14:00
 110 Tea Thanas Kuleçi 11.12.2017 14:00
 111 Uardara Artur Ismaili 11.12.2017 14:00
 112 Urgan Gazmend Mehmeti 11.12.2017 14:00
 113 Valbona Fak Biba 11.12.2017 14:00
 114 Valbona Dashnor Zheka 11.12.2017 14:00
 115 Vilma Arisli Zharullari 11.12.2017 14:00
 116 Violeta Vasi Karaku 11.12.2017 14:00
 117 Xhëska Luan Xhetani 11.12.2017 14:00
 118 Xhovana Margarit Kane 11.12.2017 14:00
 119 Zylfite Flamur Agalliu 11.12.2017 14:00

FARMACI / SEZONI XIII DHJETOR 2017

Nr. Emër Atesë Mbiemër Orari

1 Ada Artur Duraj 04.12.2017 09:00
 2 Adela Gezim Mema 04.12.2017 09:00
 3 Adeline Oemal Dida 04.12.2017 09:00
 4 Afërdisa Sadik Malaj 04.12.2017 09:00
 5 Alba Ramir Alëka 04.12.2017 09:00
 6 Alba Viktor Cahani 04.12.2017 09:00
 7 Alba Margarit Gjeci 04.12.2017 09:00
 8 Albana Gezim Malaj 04.12.2017 09:00
 9 Albana Ismail Pepa 04.12.2017 09:00
 10 Alda Angjelin Lleshi 04.12.2017 09:00
 11 Alilon Çanaj Sejdiu 04.12.2017 09:00
 12 Amela Agron Hasankolli 04.12.2017 09:00
 13 Amira Ymer Dushaj 04.12.2017 09:00
 14 Andi Shpendi Ramo 04.12.2017 09:00
 15 Anila Tomorr Hasanaj 04.12.2017 09:00
 16 Anisa Yll Farruku 04.12.2017 09:00
 17 Anisa Haki Tali (Tafi) 04.12.2017 09:00
 18 Anisa Ivzi Xhumari (Elez) 04.12.2017 09:00
 19 Antonela Jovan Mulla 04.12.2017 09:00
 20 Anxhela Aranal Gjipali 04.12.2017 09:00
 21 Anxhela Skender Rika 04.12.2017 09:00
 22 Anjeza Aslan Alko 04.12.2017 09:00
 23 Arben Sadik Çeqa 04.12.2017 09:00
 24 Arben Petro Gjini 04.12.2017 09:00
 25 Ardina Adrian Nuha 04.12.2017 09:00
 26 Arditi Ibrahim Dingo 04.12.2017 09:00
 27 Arditi Ozim Hado 04.12.2017 09:00
 28 Arditi Adem Pasha 04.12.2017 09:00
 29 Ardita Gezim Xheladini 04.12.2017 09:00
 30 Argentina Tahir Hoxhaj 04.12.2017 09:00
 31 Arjola Hilmi Duraku 04.12.2017 09:00
 32 Arinda Shkelqim Avdia 04.12.2017 09:00
 33 Arinda Baljar Sulko 04.12.2017 09:00
 34 Arjola Ilias Buri 04.12.2017 09:00
 35 Bendisa Lulezim Hoxha 04.12.2017 09:00
 36 Besart Kujtim Bada 04.12.2017 09:00
 37 Besmir Bardhyli Buba 04.12.2017 09:00
 38 Belina Niko Zaka 04.12.2017 09:00
 39 Bleldi Robert Naçi 04.12.2017 09:00
 40 Blerina Qemal Hysa 04.12.2017 09:00
 41 Blerina Kasnir Ndoci 04.12.2017 09:00
 42 Blerita Aleksander Malçoi 04.12.2017 09:00
 43 Borana Gezim Dajli (Mertika) 04.12.2017 09:00
 44 Borana Gezim Zeqoi 04.12.2017 09:00
 45 Borjanka Xhemil Kurtulaj 04.12.2017 09:00
 46 Brikena Kasnir Shehu 04.12.2017 09:00
 47 Brikena Shahin Zeha 04.12.2017 09:00
 48 Brisiana Robert Likaj 04.12.2017 09:00
 49 Brunilda Edmond Goci (Mertika) 04.12.2017 09:00
 50 Brunilda Zahir Kosji 04.12.2017 11:30
 51 Brunilda Rahim Mulla 04.12.2017 11:30
 52 Daniela Pavlo Jakaj 04.12.2017 11:30
 53 Daniela Durim Seferi 04.12.2017 11:30

54 Dejvis Ladinir Islamaj 04.12.2017 11:30
 55 Demir Shefqet Peza 04.12.2017 11:30
 56 Denada Bashkim Lasku 04.12.2017 11:30
 57 Denada Fatmir Zenelaj 04.12.2017 11:30
 58 Denald Nazmi Kopaciqi 04.12.2017 11:30
 59 Diamele Luan Lleshi 04.12.2017 11:30
 60 Dorian Jashar Suli 04.12.2017 11:30
 61 Doriana Ramazan Amalaj 04.12.2017 11:30
 62 Dorilda Rifat Ymeri 04.12.2017 11:30
 63 Dorina Camil Veizi 04.12.2017 11:30
 64 Drialdita Petriti Toska 04.12.2017 11:30
 65 Drilan Esat Çami 04.12.2017 11:30
 66 Drilan Ulis Fejzaj 04.12.2017 11:30
 67 Drilan Fatmir Nelaj 04.12.2017 11:30
 68 Dhrino Mihal Lici 04.12.2017 11:30
 69 Eden Fatmir Hoxha 04.12.2017 11:30
 70 Edjon Petriti Hysenaj 04.12.2017 11:30
 71 Edmond Shefqet Loza 04.12.2017 11:30
 72 Egi Petrit Shyti 04.12.2017 11:30
 73 Eklida Avdulla Çollaku 04.12.2017 11:30
 74 Elda Gezim Domi 04.12.2017 11:30
 75 Elda Fatmir Sefa 04.12.2017 11:30
 76 Elisa Mehmet Hoda 04.12.2017 11:30
 77 Eljon Sami Sheme 04.12.2017 11:30
 78 Elma Shahin Pasholi 04.12.2017 11:30
 79 Elona Sllako Grozadini 04.12.2017 11:30
 80 Eisaeda Camil Xhurreta 04.12.2017 11:30
 81 Elton Simon Oyteli 04.12.2017 11:30
 82 Elvi Bujar Alushani 04.12.2017 11:30
 83 Evina Ylli Fejzulla 04.12.2017 11:30
 84 Emrah Edmond Dashi 04.12.2017 11:30
 85 Endrit Jonus Lazaj 04.12.2017 11:30
 86 Enea Ibrahim Gjavori 04.12.2017 11:30
 87 Enea Irl Lushka 04.12.2017 11:30
 88 Eneida Nazmi Kazani 04.12.2017 11:30
 89 Evgjantina Gramos Shkurta 04.12.2017 11:30
 90 Emvra Enver Tukaj (Abdurrahman) 04.12.2017 11:30
 91 Emxhel Ramiz Mejdani 04.12.2017 11:30
 92 Enxhikristaq Andrea 04.12.2017 11:30
 93 Enxhikristaq Dodaj 04.12.2017 11:30
 94 Enxhikristaq Ekonomi 04.12.2017 11:30
 95 Enxhikristaq Islamaj 04.12.2017 11:30
 96 Enxhikristaq Pashollari 04.12.2017 11:30
 97 Era Hyske Kuci 04.12.2017 11:30
 98 Eraldia Vladimiri Rami 04.12.2017 11:30
 99 Ergys Petrit Urçi 04.12.2017 14:00
 100 Erindola Dilaver Shuloi 04.12.2017 14:00
 101 Erion Pellumb Elezaj 04.12.2017 14:00
 102 Erion Agron Melushi 04.12.2017 14:00
 103 Eriona Artan Hymeti 04.12.2017 14:00
 104 Erjona Albert Kaku 04.12.2017 14:00
 105 Erjona Sulejman Sinebala 04.12.2017 14:00
 106 Erlind Novrus Jahollari 04.12.2017 14:00
 107 Ermir Abaz Brahimi 04.12.2017 14:00
 108 Ervjon Shkelqim Mullaoli 04.12.2017 14:00
 109 Ervin Ylli Lavdari 04.12.2017 14:00
 110 Eskilda Kodhel Lushka 04.12.2017 14:00
 111 Eva Lirak Bajraktari 04.12.2017 14:00
 112 Evira Vidlan Meraja 04.12.2017 14:00
 113 Evisa Besnik Hasanbelli (Meta) 04.12.2017 14:00
 114 Fabiana Geg Kacodja 04.12.2017 14:00
 115 Fatbardh Mexhit Sina 04.12.2017 14:00
 116 Fatjon Salami Dashi 04.12.2017 14:00
 117 Fatmira Veiz Balukçi 04.12.2017 14:00
 118 Ferdinand Hysaj Zanaç 04.12.2017 14:00
 119 Fioralba Gediz Vani 04.12.2017 14:00
 120 Fiksim Aslan Xhanelo 04.12.2017 14:00
 121 Fjoralba Genci Zyka 04.12.2017 14:00
 122 Fjoreta Qemal Muho 04.12.2017 14:00
 123 Fjoreta Behar Dollani 04.12.2017 14:00
 124 Florian Bashkim Hajro 04.12.2017 14:00
 125 Florida Vel Oka 04.12.2017 14:00
 126 Fredjona Hysni Brahimi 04.12.2017 14:00
 127 Gerian Fatos Herri 04.12.2017 14:00
 128 Gerola Bari Gjoka 04.12.2017 14:00
 129 Gizela Zija Alko 04.12.2017 14:00
 130 Granit Avdi Zhubi 04.12.2017 14:00
 131 Greta Felin Cobani 04.12.2017 14:00
 132 Greta Fatmir Verça 04.12.2017 14:00
 133 Gritsedla Haxhi Makaj 04.12.2017 14:00
 134 Guido Arben Muharemi 04.12.2017 14:00
 135 Gjergji Nestur Dede 04.12.2017 14:00
 136 Hertha Sherif Mezinio 04.12.2017 14:00
 137 Iglie Alo Shallari 04.12.2017 14:00
 138 Ina Nazmi Mucaj 04.12.2017 14:00
 139 Ina Mehmet Stringa 04.12.2017 14:00
 140 Ina Gjergji Tane 04.12.2017 14:00
 141 Indrit Selami Repaj 04.12.2017 14:00
 142 Ines Hiti Mamilla 04.12.2017 14:00
 143 Inidri Ylli Hyseni 04.12.2017 14:00
 144 Irena Hamit Alliu 04.12.2017 14:00
 145 Irla Kujtim Doda 04.12.2017 14:00
 146 Irla Musa Bala 04.12.2017 14:00
 147 Irla Edmond Gjollu 04.12.2017 14:00
 148 Irla Sokol Dimo 05.12.2017 09:00
 149 Jasmina Samir Holi 05.12.2017 09:00
 150 Jasmina Astrit Kolushi 05.12.2017 09:00
 151 Jasmina Fatmir Mustafaj 05.12.2017 09:00
 152 Johana Sotiraj Pasku 05.12.2017 09:00
 153 Jola Janaq Pifti 05.12.2017 09:00
 154 Jona Mame Jaupiti 05.12.2017 09:00
 155 Jozef Gjoni Koliçi 05.12.2017 09:00
 156 Juliana Pellumb Osmanllari 05.12.2017 09:00
 157 Luja Kasnir Cobo 05.12.2017 09:00
 158 Juslida Gezim Sejko 05.12.2017 09:00
 159 Krala Nasa Pifti 05.12.2017 09:00
 160 Katerina Dhimiter Leka 05.12.2017 09:00
 161 Klara Arben Ziso 05.12.2017 09:00
 162 Klaudiva Lasko Mustafaj 05.12.2017 09:00

163 Klaudiva Ramiz Mejdani 05.12.2017 09:00
 164 Klea Majlind Kurti (Marqeshi) 05.12.2017 09:00
 165 Klesta Edmond Durraj 05.12.2017 09:00
 166 Klestina Suli Fillo 05.12.2017 09:00
 167 Klevis Perikli Polena 05.12.2017 09:00
 168 Kostanca Anesti Fengejli 05.12.2017 09:00
 169 Kostika Vasil Gjata 05.12.2017 09:00
 170 Krist Edmond Duro 05.12.2017 09:00
 171 Kristina Arjan Ndreu 05.12.2017 09:00
 172 Kristo Thanas Milo 05.12.2017 09:00
 173 Kujtim Shyti Oerim 05.12.2017 09:00
 174 Leda Adnan Logji 05.12.2017 09:00
 175 Leonid Zef Pitsja 05.12.2017 09:00
 176 Linda Kasnir Zenelaj 05.12.2017 09:00
 177 Lisjida Lili Dushi 05.12.2017 09:00
 178 Lisjana Ajet Hoxha 05.12.2017 09:00
 179 Loren Pal Ndreka 05.12.2017 09:00
 180 Loreta Hekuran Vrapo 05.12.2017 09:00
 181 Loriana Riza Allamali 05.12.2017 09:00
 182 Luiza Agim Hasaballa 05.12.2017 09:00
 183 Majlinda Dhimtraq Poci 05.12.2017 09:00
 184 Manjola Shpetim Leshi 05.12.2017 09:00
 185 Margarita Oemal Hysenaj (Guce) 05.12.2017 09:00
 186 Marigjen Shefqet Çela 05.12.2017 09:00
 187 Marigjen Kime Rami 05.12.2017 09:00
 188 Mariza Eduard Andersoni 05.12.2017 09:00
 189 Marjeta Musa Kodra (Muça) 05.12.2017 09:00
 190 Marseda Jonuz Gogaj 05.12.2017 09:00
 191 Marsida Bashkim Haliunje 05.12.2017 09:00
 192 Marsida Besnik Spahiu 05.12.2017 09:00
 193 Meglind Gramos Oera 05.12.2017 09:00
 194 Meglinda Shkriçaku 05.12.2017 09:00
 195 Merlin Gjergji Vargjoni 05.12.2017 09:00
 196 Migjeta Seret Regolci 05.12.2017 09:00
 197 Milika Edmond Neku 05.12.2017 11:30
 198 Mirza Hali Ahmetos (Xhafa) 05.12.2017 11:30
 199 Mirjan Kendim Skendaj 05.12.2017 11:30
 200 Mirnela Agron Kocubelli 05.12.2017 11:30
 201 Mirsada Ramadan Vuçeti 05.12.2017 11:30
 202 Monika Ahmet Ibro 05.12.2017 11:30
 203 Muhamed Jonuz Tafili 05.12.2017 11:30
 204 Muharem Isa Oqalliu 05.12.2017 11:30
 205 Nadir Fatos Çashulloti 05.12.2017 11:30
 206 Najada Fatmir Belu (Lozi) 05.12.2017 11:30
 207 Natasha Muharem Lushi 05.12.2017 11:30
 208 Nedjan Agim Dymishi 05.12.2017 11:30
 209 Neritika Kostandin Brahimi 05.12.2017 11:30
 210 Odise Ila Jalagani 05.12.2017 11:30
 211 Oka Shefqet Biheku 05.12.2017 11:30
 212 Oka Hamza Malaj 05.12.2017 11:30
 213 Oriada Arjan Pashaj 05.12.2017 11:30
 214 Orjaila Lufja 05.12.2017 11:30
 215 Pamela Sulejman Laçi 05.12.2017 11:30
 216 Paola Lambi Turshinka 05.12.2017 11:30
 217 Paula Naim Kaja 05.12.2017 11:30
 218 Pavlina Arjan Niça 05.12.2017 11:30
 219 Pranvera Osman Rredhi 05.12.2017 11:30
 220 Pranvera Rustem Selencia 05.12.2017 11:30
 221 Rajmond Oemal Vrykuçi 05.12.2017 11:30
 222 Redion Nerlan Prendi 05.12.2017 11:30
 223 Rexhina Tajar Bici 05.12.2017 11:30
 224 Rigels Krenar Zhanaj 05.12.2017 11:30
 225 Rigert Ferdinand Zhanaj 05.12.2017 11:30
 226 Rinilda Lutji Çuri 05.12.2017 11:30
 227 Roeld Roldan Mertiri 05.12.2017 11:30
 228 Romina Nebi Meta 05.12.2017 11:30
 229 Rukije Naim Sheta 05.12.2017 11:30
 230 Sabiel Petrit Mela 05.12.2017 11:30
 231 Sanela Astrit Isufi 05.12.2017 11:30
 232 Sidorela Vasil Gjergji 05.12.2017 11:30
 233 Silvana Ajet Manallari (Osman) 05.12.2017 11:30
 234 Silvi Leonard Oyteza 05.12.2017 11:30
 235 Silvia Ili Bejo 05.12.2017 11:30
 236 Sirilana Bahri Krajaç 05.12.2017 11:30
 237 Skender Haxhi Laçi 05.12.2017 11:30
 238 Stavri Nam Kura 05.12.2017 11:30
 239 Steslir Rama 05.12.2017 11:30
 240 Suela Mehmet Seferi 05.12.2017 11:30
 241 Shpresa Telik Zhurda 05.12.2017 11:30
 242 Tofik Dritan Sula 05.12.2017 11:30
 243 Theodora Vasil Kosta 05.12.2017 11:30
 244 Thoma Jani Kosdine 05.12.2017 11:30
 245 Valentinia Toti Metushi 05.12.2017 11:30
 246 Vangelio Stefan Abazelli 05.12.2017 11:30
 247 Vasil Spase Themeko 05.12.2017 11:30
 248 Vilma Sefer Gordi 05.12.2017 11:30
 249 Vilma Bujar Tafili 05.12.2017 11:30
 250 Viola Gezim Berhanio 05.12.2017 11:30
 251 Vjollca Selim Marku 05.12.2017 11:30
 252 Vladimir Oemal Hysa 05.12.2017 11:30
 253 Xheni Maksim Xhevaçiri 05.12.2017 11:30
 254 Xhensila Arit Dallas 05.12.2017 11:30
 255 Xhensika Nuri Dervishi 05.12.2017 11:30
 256 Xhuliana Artur Dexhios 05.12.2017 11:30
 257 Xhuliana Myllir Hyseni 05.12.2017 11:30
 258 Xhuliana Rustem Kuka 05.12.2017 11:30

11 Bajram Eduard Velaj 14.12.2017 09:00
 12 Benueda Ndue Kaçori 14.12.2017 09:00
 13 Bertina Xhemal Domi 14.12.2017 09:00
 14 Besjana Veledin Çepele 14.12.2017 09:00
 15 Besjana Xhaferr Durishli 14.12.2017 09:00
 16 Brisilda Myzafer Hysomemaj 14.12.2017 09:00
 17 Damianos Piro Bishani 14.12.2017 09:00
 18 Denada Hysen Lishi 14.12.2017 09:00
 19 Denis Avni Milika 14.12.2017 09:00
 20 Evgjantina Abas Kaso 14.12.2017 09:00
 21 Elvira Artan Allaj 14.12.2017 09:00
 22 Emanuela Nozi Pullumbi 14.12.2017 09:00
 23 Entela Nikollaj Buzo 14.12.2017 09:00
 24 Eranda Petrit Xheleshi 14.12.2017 09:00
 25 Erida Fatmir Mulgeci 14.12.2017 09:00
 26 Erina Dritor Daci 14.12.2017 09:00
 27 Erina Sadik Kaci 14.12.2017 09:00
 28 Eriola Luan Kabashi 14.12.2017 09:00
 29 Ermisa Kujtim Hysaj 14.12.2017 09:00
 30 Ervina Pertef Dhembi (Nalbat) 14.12.2017 09:00
 31 Ervina Astrit Hasanaj 14.12.2017 09:00
 32 Esmeralda Rezart Kovaci 14.12.2017 09:00
 33 Esmina Skender Selçetaj 14.12.2017 09:00
 34 Elvira Dilo Gjoni 14.12.2017 09:00
 35 Eva Ylber Shamelaj 14.12.2017 09:00
 36 Eva Fiqiri Shehi 14.12.2017 09:00
 37 Evelina Zef Hamataj 14.12.2017 09:00
 38 Fabiola Kujtim Kelleçi 14.12.2017 09:00
 39 Fadjana Falos Beqo 14.12.2017 09:00
 40 Fjorada Merkur Koci 14.12.2017 09:00
 41 Fratlejana Irljan Lajaj (Hoxhaj) 14.12.2017 09:00
 42 Gerald Sokol Abdryzaku 14.12.2017 09:00
 43 Gerta Bashkim Kamsi 14.12.2017 09:00
 44 Gezim Njazi Metaj 14.12.2017 09:00
 45 Greslinda Kujtim Gace 14.12.2017 09:00
 46 Gjovalin Ndoci Ndoja 14.12.2017 09:00
 47 Irlida Dhimiter Ozuni 14.12.2017 09:00
 48 Ivana Petro Kristo 14.12.2017 09:00
 49 Jonida Shefqet Ruda (Rrap) 14.12.2017 11:30
 50 Jonida Ibrahim Taho 14.12.2017 11:30
 51 Jorgo Anesti Xhumba 14.12.2017 11:30
 52 Julinda Sabri Kola 14.12.2017 11:30
 53 Klajdi Servet Kryemadhi 14.12.2017 11:30
 54 Klarida Adriatik Nelaj 14.12.2017 11:30
 55 Klejda Kleandri Koroveshi 14.12.2017 11:30
 56 Kleopatra Dhimostren Pina 14.12.2017 11:30
 57 Kloda Oemal Daci 14.12.2017 11:30
 58 Kristina Ylli Agalliu 14.12.2017 11:30
 59 Malvina Naim Sabashi 14.12.2017 11:30
 60 Manjola Falk Kotarja 14.12.2017 11:30
 61 Marjeta Refil Hyka 14.12.2017 11:30
 62 Marsida Petrit Dollani 14.12.2017 11:30
 63 Megji Adrian Babusha 14.12.2017 11:30
 64 Melisa Ferdi Çela 14.12.2017 11:30
 65 Migjena Maksim Xhepexhiu 14.12.2017 11:30
 66 Mirjana Nizam Hoxha 14.12.2017 11:30
 67 Mirsi Dilaver Mansaku 14.12.2017 11:30
 68 Mirton Genci Dizdari 14.12.2017 11:30
 69 Miruse Islam Jashari 14.12.2017 11:30
 70 Naim Isa Ruda 14.12.2017 11:30
 71 Orjoda Shpetim Cekaj 14.12.2017 11:30
 72 Ornela Naim Isufi 14.12.2017 11:30
 73 Renato Agron Agollu 14.12.2017 11:30
 74 Romina Apostol Kume 14.12.2017 11:30
 75 Romina Sotiraj Pipa 14.12.2017 11:30
 76 Romina Nuredin Skendaj 14.12.2017 11:30
 77 Sebastian Valentin Vushaj 14.12.2017 11:30
 78 Servin Valtor Meda 14.12.2017 11:30
 79 Sidorela Geg Menga 14.12.2017 11:30

STUDIMI

Në këtë proces të rishkrimit familjar të historisë, më shumë se histori dhe profesionalizëm gjenden lavde familjare dhe vlerësime folklorike

TREGIMI I (PA)PLOTË MBI PAVARËSINË:

Rishkrimi i historisë dhe sjellja shtetërore pas viteve '90

Afrim Krasniqi*

Në dhjetor '90 kur mori jetë sistemi i ri politik shoqëria shqiptare trashëgonte memorie gjysmake dhe të deformuar ndaj Pavarësisë dhe etërve themelues. Rreth gjysma e firmëtarëve dhe kontribuuesve të Pavarësisë ishin konsideruar përgjatë katër dekadave si armiq dhe kundërshtarë të regjimit, emri dhe kontributi i tyre ishin retushuar dhe censuruar, miti i PPSH dhe komunizmit ishte shumë më i madh sesa piedestali i Pavarësisë. Gjatë një anketimi të bërë disa vite më parë rreth kësaj periudhe, përqindja e atyre që besonin se E.Hoxha ka rol në Pavarësinë e vitit 1912 ishte shumë më i madh sesa konfirmimi për themeluesit e vërtetë, një tregues i nivelit të lartë të dezinformimit, manipulimit dhe propagandës me të cilën me shumë se dy breza ishin formuar.


Për pasojë, procesi i ndryshimit të sistemit dhe ai i rehabilitimit, rishkrimit të të vërtetave historike dhe e krijimit të një historie kombëtare e shtetërore rezultoi të ishte shumë më i vështirë sesa ishte menduar. Motivet lidhen jo vetëm me nivelin e lartë të retushimit gjatë viteve 1946-1990, por edhe më mënyrën sesi mori jetë pluralizmi politik dhe sistemi i ri. Thirrja "E duam Shqipërinë si gjithë Evropën" dhe ato për Fishtë, Konicën, Frashërin, etj., paralajmëronin një fillim të ri në memorien historike. Teza që lidhen me bashkimin kombëtar, modelin demokratik të shtetit, liritë dhe kulturën, hapjen dhe identitetin, - zunë vend në ligjërimin e ri, në përpjekje për të fituar kohën e humbur historike dhe për të mbushur zbrazëtinë që rënia e regjimit po linte pas. Etja ishte më e madhe sesa hapësira për ndryshim dhe mekanizmat në dispozicion.

1. RIKTHIMI I HIMNIT DHE SIMBOLEVE SHTETËRORE

Hapi i parë ishte ndryshimi, por, në fakt, ndryshimi nuk do të ishte kaq i thjeshtë dhe më shumë se akte populiste do të kërkonte ndryshim të sjelljes shtetërore, akte kushtetuese dhe ndërgjegjësimit publik, - cilësi të brishta në vitet '90-'91 në Shqipëri. Një muaj pas jetësimit të pluralizmit politik Presidiumi i Kuvendit Popullor nxori një dekret, sipas të cilit "Përmendoret, bustet dhe memorialet e çdo lloji kushtuar figurave të ndritura të historisë dhe të kulturës së popullit tonë, heroit kombëtar Gjerë Kastrioti-Skënderbeu; patriotëve

"Ka ende rrugë me emrin e Haxhi Qamilit, njerëzit mendojnë se Pavarësinë e shpalli Enver Hoxha"

"Ka zyrtarë të pas '90-ës, pa ndonjë gjurmë që kanë dekorata më të larta se Luigj Gurakuqi"



Në foto: Afrim Krasniqi

ANKETA

Gjatë një anketimi të bërë disa vite më parë rreth kësaj periudhe, përqindja e atyre që besonin se E.Hoxha ka rol në Pavarësinë e vitit 1912 ishte shumë më i madh sesa konfirmimi për themeluesit e vërtetë, - një tregues i nivelit të lartë të dezinformimit, manipulimit dhe propagandës me të cilën më shumë se dy breza ishin formuar.

të mëdhenj të Rilindjes, si vëllezërit Frashëri; luftëtarëve të shquar të Pavarësisë, si Ismail Qemali; personaliteteve të shënuar të luftës për demokraci, si F. S. Noli; udhëheqësit të Luftës Nacional-lirimtare dhe themeluesit të shtetit të ri shqiptar Enver Hoxha dhe veprimtarëve të tjerë të shquar në jetën shumëshekullore të popullit tonë, janë monumente të paprekshme dhe mbrohen me ligj nga shteti". Po ashtu me ligj do të mbroheshin edhe "flamuri kombëtar,

stema e simbole të tjera të Republikës".

Po cila mund të ishte lidhja midis Skënderbeut, Rilindjes, luftëtarëve për Pavarësi, Fan Nolit dhe Enver Hoxhës? Natyrisht dekreti lidhje me emrin e fundit dhe vendosja në të njëjtën linjë e diktatorit me etërit e Pavarësisë dhe heroin kombëtar shpreh vazhdimësinë e mentalitetit abuzues të periudhës së partisë - shtet. Po ashtu, mbrojtja me ligj e stemës dhe simboleve të Republikës, të cilat në janar 1991 ishin simboli i Kongresit të Përmetit, kallinj të grupit dhe ylli me pesë cepa, gjithashtu, jepnin mesazhin se pluralizmi politik është lejuar, por sistemi i mendimit dhe i sjelljes mbetet i njëjtë.

Në prill 1991, katër muaj pas pluralizmit, u anulua Kushtetuta e vitit 1976, e cila në nenin 3 vinte në kundërsht të plotë edhe me vetë pluralizmin, duke njohur PPSH si forcë të vetme udhëheqëse në shtet dhe në shoqëri. Deri në prill 1991 zyrtarisht Shqipëria vijonte të ishte Republikë Popullore Socialiste. Midis muajit prill 1991

dhe dhjetor 1991 Shqipëria nuk kishte asnjë ligj apo vendim rregullues për simbolet e shtetit dhe as hierarkinë e vlerave që ai duhet të nderonte. Në dhjetor 1991 parlamenti mori në shqyrtim dy nisma ligjore, por vetëm një vit më vonë, në nëntor 1992, pas rotacionit të parë demokratik, parlamenti arriti të miratojë legjislacionin e parë mbi stemën e Republikës, simbolet shtetërore dhe festat zyrtare. Ligji i ri përcaktoi stemën e Republikës, duke rikthyer simbolet e periudhës së Pavarësisë së Shtetit, të nëntor 1912. Ai, gjithashtu, përcaktoi Himnin Kombëtar, të njëjtë me Himnin e mëparshëm, por me një dallim, duke shtuar strofën e ndaluar të Himnit ku citohej fjala "Zot". Më tej ligji konfirmoi festën kombëtare dhe kryeqytetin.

GARA PËR 28-NËNTORIN, OSE PAVARËSIA E PAÇLIRUAR

Me ndërhyrjet ligjore mori jetë një konflikt i ri politik. Në fundin e vitit 1992 parlamenti shqyrtoi dhe miratoi Ligjin mbi Festat Zyrtare, përmes të cilit, hoqi nga kalendari i festave pjesën më të madhe të festave të periudhës komuniste, përfshirë edhe datën 29 Nëntor, si dhe shpalli si festat fetare, të ndaluar prej dekadash në Shqipëri. Nëse për simbolet, stemën dhe himnin kishte konsensus politik të shumicës dhe pakicës parlamentare, për festat zyrtare vendimmarrja nxiti një pistë të re të konfliktit politik, e cila vijon edhe në ditët e sotme. Nëse teza e parë ishte se pati konsensus për korrektingim e gabimeve shtetërore e politike ndaj historisë, në rastin e 28-29 nëntorit shohim se kemi të bëjmë me keqpërdorim të festave e simboleve shtetërore, përfshirë edhe Ditën e Pavarësisë, për interesa politike dhe elektorale. Sjellja që partitë dhe qeveritë kanë manifestuar ka qenë dhe vijon të mbetet shumë larg standardit të një shteti e politike serioze.

Konkretisht, me një ndërhyrje të re ligjore në nëntor 1993, parlamenti përcaktoi se "28 Nëntori dita e Flamurit dhe e Çlirimit nga pushtuesit nazifashistë". Më 1997, pas rotacionit politik mazhoranca e re bëri ndryshime në ligj duke përcaktuar se "28 Nëntori dita e Flamurit dhe e Pavarësisë është ditë e festës kombëtare" dhe se "29 Nëntori dita e Çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit nazifashistë". Pas



rotacionit të dytë politik, 2005, mazhoranca e djathtë korrektoi qëndrimin e vitit 1992 dhe 1997 duke ruajtur datën 28 dhe duke shpallur ditë pushimi edhe datën 29 nëntor.

Prej fillimit të viteve '90 çështjet protokollare të shtetit rregulloheshin me Vendime të Këshillit të Ministrave. Sipas VKM "Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë" në listën e ditëve të rëndësishme të nderimit përfshihej edhe Dita e Pavarësisë. Ceremoniali ka ndryshuar disa herë, kryesisht për shkak të raporteve me 28 dhe 29 Nëntorin, si dhe me rolin e kryetarit të shtetit dhe kryeministrit, qeverisë qendrore dhe bashkisë në këto festime. Në tërësi VKM ka mbetur unike në elementët protokollare: një vend të veçantë në Ceremonialin e Shtetit zë "ceremonia e ngritjes së flamurit kombëtar". Ajo do të zhvillohej çdo 5 vjet në qytetin e Vlorës dhe do të paraprihej nga një Komision i Posaçëm Qeveritar, me pjesëmarrje të gjerë dhe një axhendë të ngjeshur me aktivitetet. Në dallim nga disa prej ditëve dhe ngjarjeve të tjera protokollare, Ceremonia e Flamurit në Vlorë është e përcaktuar me ligj në detaje, - përfshirë orën e nisjes dhe mbarimit, vendosjen e të ftuarve, rolin e secilit prej autoriteteve qendrore e lokale, mënyra e ecjes dhe e qëndrimit, nderimi për himnin, 21 të shtënat e topit, kurora të varri i Ismail Qemalit, fjalimi i Presidentit, përshëndetjet, vizitat në familjet e patriotëve dhe të dëshmorëve, si dhe dreka zyrtare ku kryetari i bashkisë duhet të ngrejë një doli dhe të bëjë përshëndetje. Pjesë e ceremonialit është pritja zyrtare e Presidentit në të njëjtën datë në mbrëmje në Pallatin e Brigadave, etj.

Në variantin e VKM të vitit 2004 apo pas 2013 kur e majta është në pushtet, me vitet '90 apo pas 2005, kur e djathta ishte në pushtet, dallim bën vetëm ndarja ose bashkimi i ceremonive të Flamurit me atë të Çlirimit. Kur e majta është në pushtet e djathta vendos kurora në Varrezën e Dëshmorëve me datë 28 nëntor dhe anasjelltas, kur e djathta është në pushtet e majta vendos kurora në Varrezën e Dëshmorëve me datë 29 nëntor! Madje kur një parti e djathtë dhe një e majtë bënë koalicion (PD-LSI 2009-2013) njëra festonte përsëri 28 nëntorin, tjetra vijonte me 29 nëntorin.

Gara për datën nuk ishin thjesht çështje paralelizmi. ➔

Opinion i Ditës

Nga Nebil Çika *

Dekomuniztizi, punë e pambaruar e PD-së

(Vijon nga faqja e parë)

... Kur ne themi që: "Është kriminal dhe i pa pranueshëm që Gramoz Ruçi është venë me emër dhe foto në Muzeun e Gjeteve për krimet e komunizmit si një nga autorët kryesor të tyre dhe zgjidhet kryetar parlamentari", nuk kërkojmë që ai të hiqet nga Muzeu, ku është vendosur me të drejtë si një nga autorët e krimeve të komunizmit, por nga kreu i parlamentit gjë që e kemi kërkuar publikisht me të gjitha mjetet demokratike. Por, le të kthehemi te thelbi: Pse ne kërkojmë një ligj të plotë për t'i dhënë fund të paktën ligjërisht vazhdimësisë komuniste në Shqipëri. Pse tani 27 vjet pas rënies së jure të komunizmit? - na pyesin, sidomos partnerë e gazetarë perëndimorë, pyetje që me të drejtë mund t'i lindë çdo njeriu që e njeht pak apo aspak realitetin shqiptar para dhe pas rënies zyrtare të komunizmit. Ne gjykojmë, mbështetur në të drejtën ndërkombëtare se jemi ligjërisht korrekt për shkak se krimet e komunizmit, krime lufte, gjenocidi dhe krimet kundër njerëzimit nuk parashkruhen. Në këto kushte, në çdo kohë si në 1992, tani apo edhe pas 100 vjetësh këto krime mund dhe duhet të ndëshkohen si detyrim ndaj drejtësisë. Në aspektin politik kërkesa jonë bëhet edhe më aktuale pasi të gjithë jemi dëshmitarë të një projekti nga ana e qeverisë që po kthen në krye të shtetit e qeverisë emra të njohur si autorë të krimeve të komunizmit që kulmon me zgjedhjen në postin nr. 2 të shtetit shqiptar, ish-ministrit të Brendshëm të qeverisë komuniste së fundit, de jure komuniste, drejtuesit të Sigurimit kriminal të Shtetit, Gramoz Ruci. Sigurisht që nuk është vetëm ky rast pasi



rikthimi në pushtet e kupolës gjeneitike të diktaturës komuniste është një aksion politik i dukshëm vetëm duke parë emrat e mbiemrat e një pjese të mirë të qeverisë në të gjitha nivelet e saj. Por edhe në aspektin juridik, historik e human, në mos i ndëshkimit as sa e meritonjë, largimi nga postet publike të autorëve të krimeve të komunizmit është jo vetëm aktual, por një domosdoshmëri për të sotmen dhe të ardhmen e vendit.

Mendoj se PD e ka një detyrim politik e elektoral, një premtim të pa përmbushur, një punë të pambaruar ligjin për dekomunizimin e vendit. Ajo është partia që u krijua si antikomuniste një monopoli që, shpesh herë pa e merituar, e gëzon edhe sot. Ajo ka në themelin e saj politik e elektoral antikomunistët dhe të përndjekurit politikë gjë që e

detyron atë të jetë në krye të përpjekjeve të gjata e të mundimshme të shumës së shqiptarëve për t'u shpëtim nga e kaluara kriminale komuniste. Nuk është se PD nuk ka bërë asgjë për dekomunizimin, pasi mund të kujtojmë këtu ndënimin në vitin 1996 për gjenocid të 70 zyrtarëve të lartë të diktaturës komuniste midis tyre edhe diktatorin e fundit Ramiz Alia, të cilët u shpallën të pafajshëm sapa ish-komunistët u kthyen në pushtet me revolucionin e vitit 1997. Por pas kësaj periudhe antikomuniste PD e ka zbatuar në mënyrë sporadike e ka përdorur politikisht kur ka qenë në opozitë ndërkohë që në qeveri ka bërë pak apo aspak për të. Iniciativa që ka ndërmarrë z. Basha me projekt/ligjin për dekomunizimin e kthen PD-në te puna e lënë përgjysmë jo vetëm në raport me krimet komuniste, por me

krimin në përgjithësi. Një nga arritjet e mëdha të z. Basha është Ligji i Dekriminalizimit, miratimi i të cilit krijoi mundësinë e pastrimit të politikës dhe administratës shtetërore nga një pjesë e krimit, atij ordiner. Mirëpo ky ligj nuk e pastrin dot politikën e shtetit nga krimi, pasi ai nuk parashikon krimet politike, por vetëm ato ordinere. Çuditërisht në asnjë nen të tij nuk parashikohet ndalimi autorëve të krimeve të tilla si, krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid që do të mund të largonte nga politika autorët e tyre. Ligji parashikon largimi nga parlament apo poste të tjera shtetërore, të zgjedhur apo të emëruar, një person që është dënua për korupsion apo se ka trokuar drogë dhe nuk largon apo ndalin një person që ka urdhëruar vrasjen torturimin e dënimit e mijëra kundërshtarëve politikë dhe familjarëve të të e dhjetëra të rinjve shqiptarë në kufi pa asnjë bazë ligjore pa llogaritur këtu varfërinë izolimin dhe trajtimin si skllëvër të shumës së popullit të Shqipërisë. Te gjithë besoj biem dakord që këto të fundit janë vepra penale shumë më të rënda se trafikimi i drogës, shëmthëse dhe trafikimi i drogës dhe armeve ishte një nga krimet e kryera nga qeveria komuniste. A mund të pretendojmë dot në këtë situatë që dekriminalizimi është i mundur vetëm me ligjin aktual? Nuk besoj se ka një normal gjë mund ta pretendoj dot këtë. Prandaj kemi këmbëngulur dhe ngulimojmë që Shqipëria të ketë një ligj të tillë pasi, në fund të fundit, sido që t'ia vëmë emrin, dekomunizimi është de fakto e de jure dekriminalizim.

*Kryetar i Shoqatës Antikomuniste e të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë

tu siç na e vërteton edhe Zbulesa: "Pas këtyre gjërave, pas një turme të madhe, të cilën askush nuk mund ta numëronte, prej të gjitha kombeve, fiseve, popujve dhe gjuhëve; këta qëndronin në këmbë përpara fronit dhe përpara Qengjit, të veshur me rroba të bardha dhe me palma në duart e tyre. Dhe thërrisnin me zë të lartë, duke thënë: 'Shpëtimi është i Perëndisë tonë, që është ulur mbi fron dhe i Qengjit, (Krishtit)'" (Zbul. 7:9-10).

KISHA ORTODOKSE PËRBALLË KOMBEVE

Kisha e Krishtit, duke qenë besnike ndaj Shkrimit të Shenjtë (Biblës), i konsideron dhe i respekton kombet si të krijuara nga Zoti me perspektivën eskatologjike të njësimi të tyre në Krishtin, në Qiellin e ri dhe Tokën e re, ku Perëndia do të jetë i gjithi në të gjitha. Kisha, si një trup i pandarë i Krishtit, e shtrirë në kohë dhe hapësirë të globit, edhe pse e emëruar në disa vende si autoqefale (vetëqeverisëse), sipas parimit të kombeve "shtet më vete, kishë më vete", përsëri nuk ndahet duke u përshatur nacionalizmit të kombeve, i cili në vetvete do të thotë përjashtim dhe armiqësi të popujve fqinjë. Përkundrazi, Kisha Ortodokse e dënon si një herezi të mallkuar nacionalizmin, racizmin midis kombeve, po ashtu edhe na-

cionalizmin fetar, që u shfaq në formimin e kombeve të reja në shekullin XIX në Evropën Juglindore dhe Ballkan. Në Sinodin Panortodokse të Shenjtë dhe të Madh në Kostandinopojë më 10 shtator 1872 u vendos: "Kisha nuk duhet të ngatërrohet me fatin e një kombi të vetëm ose të një race të vetme".

Por Kisha si majaja midis kombeve, duke respektuar lirinë e tyre, i mbron së bashku ato në vërtetën dhe dashurinë në Krishtin. Ajo nuk i përket asnjë kombi në vetvete, por as nuk i përjashton ato, përkundrazi i fton nga jashtë, d.m.th. nga bota e mëkatit, e lakmisë së mishit, lakmia e syve dhe krenaria e jetës, të cilat shkojnë, pa bërë dallim gjinie race, gjuhe, në Mbretërinë e përjetshme të Zotit, duke i vëllazëruar ato. Apostulli Pavli shkruan: "Nuk ka as Jude, as Grek, nuk ka as skllav as të lirë. Nuk ka më burrë e grua, sepse të gjithë jeni një në Jisu Krishtin" (Gal. 3:28).

Kisha, e mbushur me urtësinë dhe diturinë e Perëndisë, i pranon të gjitha gjuhët, kulturat dhe traditat e mira të çdo kombi si gjurmë të Logosit (Fjalës), i shenjëtorin ato duke i përmbushur me hirin e Perëndisë që plotëson të mangëtat dhe drejton të shtrembrat, duke i bërë mjete komunikuese në çdo komb për të përçuar vullnetin

Hyjnor tek ato (kombet).

Ajo nuk është për uniformimin e kombeve, por për unitetin e tyre, prandaj nuk përdor një gjuhë të vetme, por me çdo gjuhë të kombeve ajo përhap ungjillin dhe i lutet Zotit për çdo komb dhe për paqen dhe vëllazërimin e gjithë kombeve. Kisha është kundër frymës globale midis kombeve ku gjithëkuj gjuhë, kulturë, terror, fe, të shkruhet në një gjë globale në emër të "dashurisë", por pa të vërtetën Hyjnore, e cila i kthen njerëzit në shifer dhe kombe të vogla në shërbëtorë të kombeve të mëdha, duke i hapur rrugën një perandorie botërore, një qytetërimi global të organizuar në të keqen në antikrishtin, si një imperializëm politik-religjioze, me arrancancën e rebelë kundër Zotit, e cila është e ngashme me kullën e Babelit.

Pavarësisht se misioni i Kishës është të predikojë dhe ta bëjë të prekshme Mbretërinë e Perëndisë, e cila nuk është e dukshme tani për tani, as e përcaktuar në një vend apo komb të veçantë, por në zemrat e besimtarëve të çdo kombi, duke mësuar se: "Se qytetaria jonë është në qiejt, nga ku presim Shpëtimtarin, Zotin Jisu Krisht" (Filipianët: 3:20), përsëri ajo ka detyrë të frymëzojë çdo besimtar të saj të përgjeshëm që jo vetëm të dojë Zotin me gjithë

zemër, shpirt, mendje dhe vullnet, por edhe të dojë të afërmin si veten: kjo gjë shprehed dhe në patriotizëm, atdheadashuri, për mbrojtjen madje deri në flim për të mirën e kombit dhe të bashkëkombësve. Në çdo Liturgji Hyjnore, (lutje zyrtare e kishës), Kisha ortodokse lutet duke i nderuar ata që ranë për fe e për atdhe.

Kisha, përkrah flamurit të saj (Kryqit), nderon flamurin e çdo kombi si simbolin e bashkimit kombëtar dhe të çdo vlerë morale dhe sakrificë sublime, ashtu siç bën dhe Kisha Ortodokse në Shqipëri ku më çdo 28 Nëntor kryen Dhokologjinë e Flamurit duke iu lutur Perëndisë me këto fjalë: "O Zot që bekon dhe shenjëtorin, bekoje flamurin tonë, dhe shpëtoje shtetin tonë dhe popullin tonë nga çdo rrezik dhe shtrëngicë, dhe drejtoje në udhën e dritës të lirisë dhe të përparimit nën hijen tënde dhe të vlerësoma ne të paverit ta kremtojmë këtë ditë të lavdëruar me nder, shëndet dhe ditë të gjata këtu dhe kudo. Se ti je Perëndi mëshirëplotë edhe njeridashës, dhe ty të drejtojmë lavdinë, Atit, Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë dhe në jetë e jetëve" Amin. (Urata e bekimit të flamurit, në Kremtoren, përkthyer nga imzot Fan S. Noli).

*Përgjegjësi i Zyrës së Katekizmit e KOASH.

HOROSKOPI

A vertical column of horoscope sections. Each section has a title (DASHI, DEMI, BINJAKET, GAFORJA, LUANI, VIRGJERESHA, PESHORJA, AKREPI, SHIGJETARI, BRICJAPI, UJORI, PESHQIT) and a small icon. The text in each section provides astrological insights for that sign.

TRAJNERI I SKËNDERBEUT



Trajneri Ilir Daja tha se skuadra e tij e dominoi Partizanin në pjesën e dytë. Trajneri i Skënderbeut pranoi edhe faktin që skuadra e tij ka mbilodhje dhe në prononcimin për RTSH Sport pohoi se pas dy ditësh me Besëlidhjen do të ketë rotacion masiv

në Kupë. "Më pëlqen fakti që pas minutës së 60-të e mbajtëm kundërshtarin në gjysmëfushën e tij. Ne nuk hyjmë asnjëherë për barazim, por me një kundërshtar si Partizani, aq më tepër në fushën e tij, mendoj se një barazim është i pranueshëm. Rezultati më i drejtë ishte

Ilir Daja: E dominoam Partizanin, ata kishin më shumë kohë për këtë ndeshje

barazimi. Megjithatë, të dominosh pas minutës së 60-të deri në fund me gjithë mbilodhjen në Europë, atëherë do të thotë se jemi në rrugën e duhur. Kemi pasur një ngjeshje ndeshjes duke luajtur çdo tri ditë thuasje. Nuk kemi mundur të bëjmë dot as rotacionin e duhur. Mendoj se e gjithë kjo ka ndikimin e vet, por ka edhe anë pozitive, sepse ekipi ka ritëm tjetër të përfituruar nga ndeshjet e Ligës së Europës. Nespor nuk ka qenë pjesë e Skënderbeut dhe pa dis-

kutim nëse do të kishte qenë mirë fizikisht, atëherë do kish pasur më shumë minuta dhe do kishte pasur pak frymëmarrje për Souenë. Një alternativë e mirë brenda grupit do t'i kish dhënë frymëmarrje Souesë", tha trajneri. "Pasnesër kemi një ndeshje për Kupën e Shqipërisë. Kemi vendosur që të përdorim lojtarët që kanë pak minutazh. Përfshi këtu edhe Nimagën me Jashanicën që kanë qenë të dëmtuar. E bëjmë këtë që pjesë tjetër të jetë sa më në formë

për ndeshjen me Kukësin. Ne duam që në ndeshjen me Kukësin të dalim sa më mirë. Uroj që Partizani të ndryshojë në të ardhmen, sepse i bën mirë kampionatit. Sot ishte një terren i vështirë dhe shpenzuam shumë më tepër energji. Këto nuk janë justifikime, por Partizani ka pasur më shumë kohë për ta përgatitur për këtë ndeshje. Gjithsesi ata mbeten një vlerë e shtuar dhe sot realistisht ishin agresivë, por mbetet për t'u parë në vijim. Kaq mund të them për këtë skuadër sepse më duhet të flas më shumë për ekipin tim", deklaroi Daja.

ISH-TRAJNERI KUQEZI



Shkarkohet De Biasi, trajneri: Faleminderit Alaves!

Xhani De Biasi shkarkohet nga detyra e trajnerit të Alaves në Primera Division. Klubi spanjoll e zyrtarizoi vendimin nëpërmjet një komunikate për shtyp, ku sqaronte ndërprerjen e kontratës me ish-trajnerin e Shqipërisë, i cili vetëm pak kohë më parë zëvendësoi Zubeldian. "Klubi bardhekaltër ka vendosur në ndërpresë kontratën me De Biasin, pas rezultateve të dobëta të javëve të fundit. Për momentin, skuadrën do ta drejtojë Javier Kabejo. E falënderojmë De Biasin për punën e kryer në këtë periudhë dhe i urojmë fat në të ardhmen." De Biasi, në eksperiencën e tij të dytë në La Liga (ka drejtuar Levanten në sezonin (2007-2008), e mori Alavesin në vendin e fundit të renditjes, me zero pikë dhe zero gola të shënuar në pesë javët e para. Pavarësisht pritshmërive të larta, nuk mundi të ndryshonte shumë gjëra, duke koleksionuar 2 fitore dhe 5 humbje në 7 ndeshje në pankinë (plus një fitore në Kupën e Mbretit ndaj Getafes). Pas javës së 13-të, skuadra baske vijon të klasifikohet e fundit me 6 pikë. Në një postim në "Facebook", teknikun Xhani De Biasi, ka falënderuar të gjithë djemt e skuadrës së Alaveshit, pavarësisht se u shkarkua nga detyra e trajnerit. Ish-tekniku i Kombëtares, shprehet se keqardhja e vetme ishte se nuk pati kohë për të ndërthtur një ekip me frymë të përbashkët. Ai gjithsesi, falënderon edhe tifozët, dhe në fund thotë, "Forca Alavesh". Italiani e mori skuadrën me asnjë pikë, dhe gjatë periudhës që kaloi në Spanjë, mori vetëm dy fitore. Ja postimi i tij i plotë. "Gjëja e parë që dua të them është: Faleminderit Alavesh! Faleminderit djemve që punuan për të ndryshuar rrugën, të gjithëve atyre që na ndihmuan të përmirësonim situatën. Keqardhja më e madhe është se nuk patëm kohë për të krijuar një ekip me frymë të përbashkët dhe një identitet ndryshe. Faleminderit të gjithë tifozëve bardhë e kaltër; të cilët kanë qenë dhe do të jenë gjithmonë së bashku për ekipin e tyre. Forca dhe kurajë djem! Forca Alavesh!

Protagonist, gjyqtari me dy momente në disfavor të të zotëve të shtëpisë

Partizani e Skënderbeu ndahen në barazim

Të kuqtë flirtojnë me fitoren, por gabojnë para portës



Jeton Selimi

Partizani priste Skënderbeun në krye të ndeshjes që do të ishte siparin e javës së 12-të të Kategorisë Superiore. Në "Selman Stërmasi" mungoi spektakli, por jo dëshira për të luftuar, ndërsa të kuqtë iu afruan më shumë suksesit me disa momente të mira shënimi, sidomos në pjesën e dytë. Në minutën e 4-të të kuqtë do të shënojnë me Prognin, por kryesori Hamitaj ka anuluar golin i sinjalizuar nga vijërojtësi për një pozicion jashtë loje. Gjithsesi mbetet i diskutueshëm ky moment. Skënderbeu reagon mirë në minutën e 20-të dhe Xhejms në zonë ka të gjitha shanset për të shënuar, por do të gjuajë mbi tra, ndërsa në minutën e 39-të Shehi grushton me vështirësi predhën e Idi Bathës. Më i qartë në lojën e tij, Skënderbeu, në minutat e fundit të pjesës së parë, por munguan rastet e pasura. Pjesa e dytë nisi pa asnjë ndryshim në formacionet respektive,



ndërsa Partizani është më kërkues, por sinjalin e parë e dha Skënderbeu, me dyshen

Xhejms-Soue, por me nigerianin që gaboi në marrjen e topit. Asani siluron Shehin

nga distanca e largët në të 56-ën, ndërsa veteran grushton në këndore, ndërsa 10 minu-

ta më pas, Lorenc Trashi gabon në mënyrë të pafalshme, ndonëse është vetëm pak metra larg portës dhe i pa shqetësuar. Në minutën e 74-t, pati edhe një pretendim për 11-metërsin nga kryeqytetasi, me anë të sulmuesit Asani, por për gjyqtarin ishte çdo gjë e rregullt. Në kohën shtesë, Sukaj ka në këmbët e tij mundësinë për të shënuar golin tre pikësh, por shkodrani e vendos emrin e tij në listën e atyre që gabuan në këtë 90 minutësh. Skënderbeu e rrit diferencën e pikëve në 6 me Kukësin e vendit të dytë, ndërsa Partizani me i bashkohet Laçit e Teutës me 15 pikë.

TRAJNERI AKUZON

Dalipi: Partizanit i mungon një penallti, Progni nuk ishte jashtë loje

Zvtrajneri i Partizanit, që drejtoi skuadrën nga stoli Klevis Dalipi u ankuar për gjykimin pas ndeshjes me Skënderbeun. Në prononcimin për RTSH Sport, zvtrajneri pohoi se skuadra e tij nuk shfrytëzoi as rastet që iu krijuan. "Ne i patëm dy mundësi, por nuk mundëm të shënonim. Ishim të pafat në një ndeshje si kjo. Në rastin e Prognit nuk mendoj se ishte jashtë loje. Në momentin që u fut Sukaj, e paralajmëruam që do t'i vinte një mundësi, por ishte i pafat. Mund t'i



kishte folur dikush nga mbrapa që je vetëm. Ndërsa në rastin e Asanit ishte penallti, sepse Jashanica nuk

ishite fare i interesuar për topin. Ishim të përgatitur për të përballuar një kundërshtar si Skënderbeu. Kur mbaroi pjesa e parë i paralajmëruam lojtarët, sepse e dinim që ndeshjen do ta vendosnim episodet, por për fat të keq me dy raste flagrante në sërish nuk mundëm të shënonim. Më vjen keq për këtë. Të qenit trajner i parë? Ishte privilegj i madh. Por unë jam besnik i Starovës dhe i klubit. Më vonë, nëse krijohen mundësitë, atëherë të shohim", - deklaroi Dalipi për mikrofonin e RTSH.


RISIA E BOTËTORIT

Nëse ka thirrje raciste, ndërpritet ndeshja

Kur kanë mbetur edhe 4 ditë nga hedhja e shortit të grupeve për Botërorin e Rusisë, presidenti i FIFA-s, Xhani Infantino ka komunikuar me anë të një video. Qëllimi i saj ishte për të folur rreth një nga problematikat më të prekshme në botën e futbollit, racizmin. "Racizmi është një prej prioritetëve tona dhe ne duam të jemi të sigurt se asgjë nuk të ndodhi. Nëse incidente të tilla do të përsëriten, atëherë arbitri do të ndalojë ose krahtisë ndeshjen, nëse thirrjet raciste vazhdojnë në stadium. Kjo është totalisht e palejueshme për ne dhe ajo e cila duhet të luhet në Rusi, është një lojë miqësore". Kjo është një masë e duhur, e cila i mungonte botës së futbollit, ndërkohë që racizmi është duke u përhapur gjithmonë e më shumë. Xhani Infantino e ka gjetur zgjidhjen e tij, ndërsa koha do e tregojë sesa rezultat do të japi ky vendim.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Një pije freskuese.
- Graf ish tenisiste.
- Dada, ish-diktator i Ugandës.
- Eshhtë pasuri e investuar.
- Mund të jenë fetare.
- Një pjesë e relacionit.
- Fillojnë ambalazhimin.
- Një vegël.
- Qe harkëtar i famshëm i akejeve.
- Fillojnë hetimin.
- Një atentator vëtvërsasës.
- Kështu janë takimet zyrtare.
- Eshhtë anije me dy skafë.
- Fundi i Turandot.
- Inicialet e Reitman regjisor.
- Farell regjisor.
- Schneider që qe aktore.
- Mund të jetë e lirë për hartim.
- Emri i Pasternak.
- Ekberg e La dolce vita.

- Dikur qehje Mediolanum.
- Ruajnë pa ujë.
- Një mund të jetë kalendarik.
- Një është meskini, shpirtngushti.
- Një hidrokarbur.
- Mund të jetë franceskan.

VERTIKAL

- Jessica Parker aktore.
- Zola shkrimtar.
- Janë dritë të tilla me parsec.
- Mund të jenë gjaku.
- United Kingdom.
- Eshhtë njeri me principe.
- Një polimer për kirurgji estetike.
- Kufizojnë takimet.
- Diftong teatral.
- Fillojnë fluturimin.

- Makina Uno.
- Eshhtë shpend lagune.
- Eshhtë operator që bën zoom.
- Eshhtë i pashpirt.
- Parashtesë për një.
- Pak enigmatike
- Një pjesë e Toskërisë.
- Agustini ish-bomber.
- Kufizojnë njëen princip.
- Miku i Batman.
- Tapeti për judo.
- Janë statet në videogame.
- Bëhet një kundër vendimit.
- Janë me blerim mbuluar në një film
- Eshhtë shtet aziatik.
- Papavrami violinist
- Fadili komik
- Përhëndetja e Jul Qezarit.
- Mbyllin fushatat.
- Me të bëjnë një ketër.
- Mbyllin një takimim.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Një pemë gjigante.
- Janë për të kërcyer.
- Ishte shkolla e Aristotelit
- Një thirrje me emra.
- Gjysmë rivale.
- Një pjesë e narkotikëve.
- Një tis... mjegulle
- E famshme ajo e Keopsit
- Mbyllin një sirtar
- Eshhtë ngjyrë e... fytyrës.
- Fillojnë lejen.
- Janë aktorë kryesorë.
- Janë kompozime të kënduara.
- Hudson aktore.
- Satelit i Uranit.
- Fillojnë tatëpëpën.
- Mbetur në fund.
- Sapo fillojnë.
- Kastile janë në fund.
- Kufij takimi.
- Ekstremet e tokës.

VERTIKAL


- Mund të jetë sekrete në derë.
- Makina Agia.
- Ami i Maupassant.
- Mbyllin një sirtar.
- Rëzohen me strike
- Luciano tenor i paharruar.
- Mbyllin këndet
- Eshhtë borxh.
- Mbyllin portat.
- Një pjesë e akademisë.
- Bien me ballë.
- Një barkë lëkurakugsh.
- Atje ku shkon progresisti
- Pallati i Dalai Lamas në Lhasa
- Një pjesë e minoritetit.
- Eshhtë fluturues në ufo.
- Do të bëhen mace të tilla.
- Fletë pa kufij.
- I ka tek rendi.
- Kreshniku i volejbollit.
- Një det që është liqen në fakt.
- As urë, as ai.
- Në mes të King edhe Cole të muzikës.
- Një parashtesë zmadhuese.
- Eshhtë Ilon papagalli.
- Titulli i Sean Connery.
- Fillojnë panikun.
- Gjysma e rojave.
- Fitim pa kufij.
- Mbyllin një sherr.
- Fillojnë një metodë.
- Kufizojnë botimet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	T	M	L	T	R	A	J	T	A
P	L	K	A	P	A	L	I	E	N
R	E	K	O	R	D	E	T	P	M
I	A	N	S	A	M	B	L	I	H
M	A	R	T	I	N	E	D	E	N
O	H	A	R	A	T	T	I	T	R
B	A	N	A	P	I	S	H	E	I
E	P	I	T	E	T	T	E	S	T
M	I	N	A	T	N	A	I	M	A
I	K	A	A	K	A	R	I	M	A
L	A	P	A	R	A	R	O	J	A
E	T	I	K	A	S	E	N	A	T
K	A	A	S	L	U	L	I	M	A
A	R	R	A	S	B	A	R	N	U
L	A	T	A	B	R	O	A	E	F
M	I	N	A	T	N	A	I	M	A
A	N	E	T	A	R	E	S	I	A
M	I	N	I	M	A	L	A	L	E
I	K	L	E	T	A	R	E	M	A
P	E	S	E	N	I	N	E	R	T
P	A	N	A	I	M	E	K	N	I
E	T	N	A	E	M	I	N	E	M
L	O	T	A	S	D	R	I	T	A
A	L	A	I	N	E	M	I	S	A

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

	3	1				6		7
				3	7		4	9
	8			4		5		2
		7	6					8
	9	2	5		1	4	6	
3					4	2		
2		4		5				9
5	6		7	1				
9		8				3	1	

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	3	5	8	4	6	1	7	2
2	6	7	3	9	1	4	8	5
1	4	8	5	7	2	3	6	9
4	9	2	6	8	5	7	1	3
6	8	1	2	3	7	9	5	4
7	5	3	4	1	9	6	2	8
8	7	9	1	2	4	5	3	6
3	1	6	9	5	8	2	4	7
5	2	4	7	6	3	8	9	1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Kush është i zgjuar? Ai që mëson nga të gjithë. Kush është i fuqishëm? Ai që zotëron pasionet. Kush është i pasur? Ai që është i kënaqur. (Benjamin Franklin)

- Të mos dish disa gjëra të caktuara, është një pjesë e rëndësishme e zgjuarsisë. (Hugo Grotius)

- Çdo njeri është një copë budalla për të paktën pesë minuta në ditë, zgjuarsisë është të mos e kaloni këtë kufi. (Elbert Hubbard)



Thënie të mënçura

- Kur ti të fitosh, unë me krenari do i them botës: "Ky është miku im". Por kur të humbasësh, unë do të jem pranë teje duke të shtrënguar dorën dhe të them: "Unë jam miku yt."
- Jeta është si një libër, varet si e shkruan dhe me çfarë boje...
- Duke mbrojtur veten ke mbrojtur tjerët; duke mbrojtur tjerët ke mbrojtur veten.
- Fjalët kanë fuqinë e të shkatërruarit dhe të krijimit; kur fjalët janë të singëta dhe të këndshme mund të ndryshojnë botën.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

8	A	1	11	16	7	5	15	9		3	9
1	Z	8	13	8	6	6	8	4	3	8	12
2	I	7	10	8	9	2	15	2	11	3	2
9	L	14	8	12	17	12	3	7	9	9	2
4	8	6	5	2	15	8	7	15	10	7	
7	5	7	12	7	15	6	11	6	8	15	
5	6	4	7	5	2	18	2	11	19	7	
5	4	11	6	19		9	8	4	8	6	
9	11	15		1	7	5	8	19	8	1	8
7	6	2	14		14	7	16	11	15	7	
5	7	8	4		8	9	3	8	15	7	5

R	O	M	A	N	C	I	E	R	E	T	C
I	R	O	N	L	E	T	R	U	P		
T	R	T	A	R	T	A	R	E	T		
K	A	M	E	R	I	E	R	E	T	U	
D	E	L	I	R	A	N	T	E	T	P	R
C	T	A	B	O	R	A	T	A			
K	R	I	P	E	A	O	L	E			
S	L	O	I	L	P	R	A	U	L		
T	A	N	T	A	L	I	U	R	R	A	
U	S	R	E	K	I	P	I	T	E		
F	A	T	A	L	A	L	I	E	N	E	T
E	T	A	P	A	T	K	A	T	E	T	I

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

Korça

KRIZA POLITIKE, SOT TAKIMI RAMA-BASHA

Agron Duka: Ju rrëfej darkën në Mullët me Fatos Nanon

Sherri për katëmbet, Rosa Lali: Do t'i jap kastrovece Rezari Velezhija i "Partiakallisë" ndahet nga e fejuara

Tashmë edhe lundroni!

